



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 280, Datë 01.11.2022

MBI

**MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HARMONIZUARA TË ALOKIMIT TË
KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT PËR ZYRËN E KOORDINIMIT TË
ANKANDEVE NË EUROPËN JUGLINDORE (SEE CAO) PËR KUFIJTË SHQIPËRI -
GREQI, SHQIPËRI - MALI ZI DHE SHQIPËRI -KOSOVË**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe nenit 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 01.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1537/1 prot., datë 03.10.2022 dhe informacionin shtesë me nr. 1537/2 prot., datë 28.10.2022, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi miratimin e Rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për zyrën e koordinimit të ankandeve në Europën Juglindore (SEE CAO) për kufijtë Shqipëri-Greqi, Shqipëri - Mal i Zi dhe Shqipëri - Kosovë”,

Konstatohet se:

- Shoqëria Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 5542 prot., datë 12.09.2022, protokolluar me tonën nr.1537 prot., datë 13.09.2022, nëpërmjet së cilës ka përcjellë për miratim “Rregullat e Harmonizuara të Alokimit të SEE CAO (Zyrën e Koordinimit të Ankandeve në Europën Juglindore), për kufijtë Shqipëri - Greqi, Shqipëri - Mal i Zi dhe Shqipëri - Kosovë, të ndryshuara, cilat do të hynë në fuqi menjëherë dhe do të bëhen plotësisht të aplikueshme duke filluar nga data 1 Janar 2023”.
- Aplikimi i këtyre rregullave do të bëhet me faza, për këtë arsye për ankandet mujore për periudhën Nëntor - Dhjetor 2022 do të aplikohen “Rregullat e harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 197, datë 26.11.2020 ndërsa për ankandin vjetor për vitin 2023 do të aplikohen rregullat e vlerësuara për miratim në këtë vendim.
- Ndryshimet e propozuara konsistojnë kryesisht në këto çështje:
 - Futja e llogarisë së dedikuar të biznesit;

- Përshkrimi i ngjarjes nxitëse/shkaktuese në rast reduktimi;
 - Përcaktimi i (DAFD) afatit të ditës përpara/në avancë (sipas Nenit 58 të EU HAR) - DAFD të publikohet veçmas (Ref. neni...., SEE CAO);
 - Regjimet e kompensimit në rast reduktimi (sipas Nenit 59-61 të EU HAR);
 - Ndryshimet në shlyerjen e faturave (të parashikuara në Nenin 65 të EU HAR) - pëson ndryshim nga versioni aktual i Shtojcës Specifike për Kufijtë e Zonave të Ofertimit të mundësuar nga EE CAO në Rregullat e Harmonizuara të Alokimit për të Drejtat Afatgjata të Transmetimit", vetëm në zgjatjen e afatit; Shtuar një nen i ri "Procesi dhe njoftimi i reduktimit/ndërprerjen në rastin e ngjarjes nxitëse" (sipas Nenit 5 7(3) të EU HAR).
- Këto propozime për ndryshime kanë prekur një sërë çështjesh dhe për pasojë nuk kërkohet amendimi i vendimit nr. 197, datë 26.11.2020 "Për miratimin e Rregullave të Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve në Europën Juglindore (SEE CAO) për Kufijtë Shqipëri - Greqi, Shqipëri - Mali zi dhe Shqipëri - Kosovë", por kërkohet shfuqizimi i këtij vendimi dhe i këtyre rregullave dhe hyrja në fuqi e rregullave të reja të SEE CAO, të përcjella për miratim në ERE nga OST sh.a., pasi kanë kaluar procesin si vijon:
 - Diskutimi në grupet e punës me pjesëmarrës nga të gjitha OST-të aksionere të SEE-CAO dhe hartimin e draftit përfundimtar me ndryshimet e Rregullave të Alokimit të SEE-CAO ("Shtojca Specifike për Kufijtë e Zonave të Ofertimit të mundësuar nga SEE CAO në Rregullat e Harmonizuara të Alokimit për të Drejtat Afatgjata të Transmetimit" dhe "Rregullat për Alokimin e Kapacitetit ditor eksplicit në zonat ofruese kufitare të ofruar nga SEE CAO").
 - Miratimi në datën 3 Qershor 2022, nga Bordi i Drejtorëve të SEE CAO, të ndryshimit të Rregullave të Alokimit të SEE CAO ("Shtojca Specifike për Kufijtë e Zonave të Ofertimit të mundësuar nga SEE CAO në Rregullat e Harmonizuara të Alokimit për të Drejtat Afatgjata të Transmetimit" dhe "Rregullat për Alokimin e Kapacitetit ditor eksplicit në zonat ofruese kufitare të ofruar nga SEE CAO").
 - Zhvillimi i konsultimeve publike, nga data 15 Korrik 2022 deri në 15 Gusht 2022. Gjatë konsultimeve publike nuk pati asnjë propozim apo kërkesë për ndryshim të akteve të publikuara me ndryshimet përkatëse.
 - Miratimi i Rregullave të Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve në Europën Juglindore (SEE CAO) për Kufijtë Shqipëri - Greqi, Shqipëri - Mali zi dhe Shqipëri - Kosovë, nga të gjithë rregullatorët e vendeve anëtare të SEE – CAO është kusht për zbatimin e tyre.
 - Me vendimin nr. 197, datë 26.11.2020, ERE vendosi miratimin e "Rregullave të Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve në Europën Juglindore (SEE CAO) për Kufijtë Shqipëri - Greqi, Shqipëri - Mali zi dhe Shqipëri - Kosovë", në këto rregulla për herë të parë u përfshi dhe kufiri ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe ankandet për interkoneksionin në këtë kufi të realizohen në këtë zyrë.
 - Sa i përket interesave që palët e treta mund të kenë në lidhje me këtë akt rregullator, sqarojmë se SEE CAO nga data 15 Korrik 2022 deri në 15 Gusht 2022, ka realizuar procesin e konsultimeve publike. Po ashtu në datën 10.10.2022 është publikuar dokumenti në

rubrikën konsultime në faqen web të ERE. Aplikimi i këtyre rregullave fillon në vitin 2022 respektivisht dy muaj para vitit pasardhës dhe bëhen plotësisht të aplikueshme në Janar të vitit 2023.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Rregullave të Harmonizuara të Alokimit të SEE CAO, për kufijtë Shqipëri - Greqi, Shqipëri - Mal i Zi dhe Shqipëri - Kosovë, si dhe anekset e këtij dokumenti. (bashkëlidhur).
2. “Rregullat e harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 197, datë 26.11.2020 do të aplikohen për ankandet mujore dhe ditore për periudhën Nëntor - Dhjetor 2022.
3. Me përfundimin e periudhës së shprehur në pikën 2 të këtij vendimi, “Rregullat e harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit të miratuara me Vendimin e bordit të ERE nr. 197, datë 26.11.2020, shfuqizohen.
4. Për çdo mospërputhje mes versionit në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhën angleze, palët duhet t’i referohen versionit në gjuhën angleze.
5. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqërinë OST sh.a., dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

Njoftim

Ky Dokument nuk përfaqëson, në asnjë rast, një pozicion detyrues ose përfundimtar për OST-të mbi përmbajtjen e tij. Ky version lëshohet në emër të OST-ve të përfshira vetëm për qëllime të konsultimit të publikut mbi Rregullat e Harmonizuara të Alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit. Diskutimi i OST-ve dhe Rregullatorëve të përfshirë, në lidhje me draftin e aneksit nuk është përfundimtar.

Nëse ndonjë dispozitë e Rregullave të Harmonizuara të Alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit, të paraqitura më poshtë, është në kontradikta me legjislacionin kombëtar në fuqi, rregullat e alokimit për kufijtë përkatës do të ndryshohen për të qenë në përputhje me legjislacionin përkatës ose për t'iu referuar legjislacionit përkatës kombëtar.

Shtojca Specifike për

Kufijtë e Zonave të Ofertimit të mundësuara nga SEE CAO

në Rregullat e Harmonizuara të Alokimit për të Drejtat Afatëgjata të Transmetimi

TITULLI 1

Dispozita te Përgjithshme

Neni 1

Objekti dhe fusha e veprimit

1. Kjo Shtojcë e rregullave të harmonizuara të alokimit për të drejtat e transmetimit të afatgjatë në nivel të Bashkimit Evropian (këtu e tutje referuar si "HAR") lidhet me Nenin 51 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 për krijimin e një udhëzuesi mbi Alokimin e Kapaciteteve Forward (në tekstin e mëtejme "Rregullorja FCA") që nuk është drejtpërdrejt e zbatueshme për kufijtë e zonave të ofertimit jashtë Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejme "BE"). Qëllimi i kësaj shtojce të HAR (në vijim referuar si "Shtojcë/Aneks") është të përfshijë HAR (tw ndryshuar nga kjo Shtojcë) në funksionimin e Platformës së Alokimit. Përveç nëse shprehimisht përcaktohet ndryshe në këtë Shtojcë, dispozitat e këtij Aneksi zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë kufijtë e Zonës së Ofertimit të listuar në Shtojcën 1 të këtij Aneksi.

Kjo Shtojcë merr në konsideratë, kur është e aplikueshme, dispozitën mbi parimet e përgjithshme të Rregullores (BE) 2019/943 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 5 Qershor 2019 mbi tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe Rregullores (KE) Nr 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 Korrik 2009 mbi kushtet për qasje në rrjetin për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike.

2. Aktivitetet e Platformës së Alokimit kanë të bëjnë me juridiksionet e operatorëve të sistemit të transmetimit (më poshtë referuar edhe si OST) nga Bashkimi Evropian, OST-ve nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe juridiksionet e OST-ve nga vende të tjera për të cilat shërbimet ofrohen nga Platforma e Alokimit. Referencat për OST-tw ose Operatorwt e Sistemit të Transmetimit përfshijnë referenca për OST-të e BE-së, Operatorët e Sistemit të Transmetimit nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe operatorët e sistemit të transmetimit nga çdo shtet tjetër për të cilin ofrohen shërbime nga Platforma e Alokimit, ndërsa Autoriteti Kombëtar Rregullator (këtu e më poshtë referuar si NRA) përfshin referenca për NRA-të e Bashkimit Evropian, NRA-të nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ose autoritetet kombëtare rregullatore të vendeve të tjera që kanë juridiksion mbi OST-nw përkatëse ose Platformën e Alokimit.

3. Në përputhje me Nenin 4 (Specialitetet rajonale) të HAR, specifikat rajonale ose kufitare mund të prezantohen për një ose më shumë kufij të Zonës së Ofertimit.

4. Rregullat e përshkruara në këtë Aneks do të zbatohen për kufijtë e Zonës së Ofertimit siç renditen në Shtojcën 1 të këtij Aneksi Nëse ka një mospërputhje midis ndonjë prej dispozitave në organin kryesor të HAR dhe kësaj Shtojce, do të mbizotërojnë dispozitat në këtë Shtojcë.

5. Termat me shkronja të mëdha të përdorura në këtë Shtojcë janë përcaktuar në HAR të cilave i bashkangjitet kjo Shtojcë, përveç nëse specifikohet ndryshe më poshtë:

Llogaria e Biznesit nënkupton një llogari depozite të dedikuara, të hapur nga Platforma e Alokimit me qëllim sigurimin e kolateraleve në një formë të depozitimit të parave nga Pjesëmarrësit e Regjistruar, të cilat mund të përdoren për pagesa nga Pjesëmarrësi i Regjistruar;

Platforma e Alokimit nënkupton Zyrën e Koordinuar të Ankandit në Evropën Juglindore d.o.o. Podgoricë, Mali i Zi (**SEE CAO**) dhe zëvendëson termin "Platforma e Vetme e Alokimit" të përcaktuar në HAR;

Neni 2

Data e hyrjes në fuqi dhe zbatimi/Data dhe aplikimi efektiv

1. Kjo Shtojcë do të hyjë në fuqi në datën e shpallur nga Platforma e Alokimit, duke iu nënshtruar miratimit të HAR dhe kësaj Shtojce nga autoritetet përkatëse rregullatore kombëtare. Kjo Shtojcë mund të rishikohet me kërkesë të autoritetit(ve) rregullatorë kombëtar përkatës. Në rast se kjo Shtojcë duhet të ndryshohet bazuar në një vendim të autoritetit(ve) rregullator/e përkatës/e, do të zbatohet neni 68 (Kohëzgjatja dhe ndryshimi i Rregullave të Alokimit) i HAR.

2. Lista e kufijve të Zonës së Ofertimit (Shtojca 1) për të cilën zbatohen HAR dhe Aneksi, duke përfshirë informacionin mbi llojin e të Drejtave Afatgjata të Transmetimit të Alokuar, mund të ndryshohet ose plotësohet në përputhje me dispozitat që kanë të bëjnë me amendimin e HAR,.

3. Për qëllim të përfshirjes së amendamentit, kërkohet që të konsultohen vetëm ose të kërkohet miratimi i një NRA-je që ka juridiksion mbi OST-n përkatës ku kufiri i Zonës së Ofertimit është ndryshuar ose shtuar.

TITULLI 2

Amendimet në HAR

Neni 3

Përshkrimi

Përshkrimet në HAR do të zbatohen për të gjitha OST-të, megjithatë, në lidhje me OST-tët që nuk janë nga Bashkimi Evropian, ato zbatohen mutatis mutandis.

Neni 4

Platforma e Alokimit

Neni 3 (Platforma e Alokimit) të HAR ndryshohet si vijon: 1. Paragrafi 1 lexohet: "1. Platforma e alokimit do të ndërmarrë funksionet e alokimit në përputhje me këto Rregulla të Alokimit, legjislacionin e aplikueshëm të Bashkimit Evropian ose aktet ligjore në fuqi të Komunitetit të Energjisë dhe / ose legjislacionin kombëtar të aplikueshëm të një ose më shumë nga vendet kufitare të Zonës së Ofertimit. ".

Neni 5

Dorëzimi i informacionit

Neni 9 (1) (Dorëzimi i informacionit) i HAR do të ndryshohet si më poshtë:

1. paragrafi (g) do të lexohet: "(g) Kodi i Identifikimit të Energjisë (EIC) ";

2. paragrafi (l) do të lexohet: "(l) Kodi i Regjistrimit të ACER (Kodi i ACER) i caktuar nga Agjencia Evropiane për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) gjatë procesit të regjistrimit të pjesëmarrësve në treg me NRA-në, për pjesëmarrje në alokimin në kufijtë e Zonës së Ofertimit të listuar në Shtojcën 2;

Neni 6

Kërkesat rregullative dhe ligjore

Neni 18 (Kërkesat rregullative dhe ligjore) të HAR ndryshohet si vijon: "Është përgjegjësi e secilit pjesëmarrës të tregut që të garantojë përputhjen me legjislacionin kombëtar dhe kur është e zbatueshme, legjislacionin e Bashkimit Evropian ose aktet ligjore të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë kërkesat e çdo autoriteti përkatës kompetent dhe ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme në lidhje me pjesëmarrjen e tij në Ankand ose në transferimin dhe përdorimin e Të Drejtave të Transmetimit Afatgjatë ".

Neni 7

Forma e Garancisë Bankare

Neni 21(1) (Forma e Garancisë Bankare) i HAR do të ndryshohet si më poshtë:

1. paragrafi (h) do të lexohet: "(h) banka që lëshon Garancinë Bankare do të themelohet përgjithmonë, duke përfshirë nëpërmjet degës në shtetin anëtar të BE-së, Zonën Ekonomike Evropiane, Palën Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, Vendin Vëzhgues të Komunitetit të Energjisë ose Zvicrën dhe do të jetë e pranueshme për bankën e biznesit të Platformës së Alokimit;" dhe

2. paragrafi (i) do të lexojë: "(i) banka që lëshon Garancinë Bankare ose grupi financiar ku bën pjesë do të ketë një vlerësim kredie afatgjatë jo më pak se BBB- nga Standard and Poor's Corporation, BBB- nga Fitch ose Baa3 nga Moody's Investors Service Inc. Nëse banka emetuese ose grupi financiar, të cilit banka emetuese i përket pushon së pasuri vlerësimin e kërkuar afatgjatë të kreditit, Pjesëmarrësi i Regjistruar duhet brenda pesë (5) Ditë Pune të paraqesë në Platformën e Alokimit një Garanci Bankare zëvendësuese nga një bankë në përputhje me vlerësimin e kërkuar afatgjatë të kreditit ose të zëvendësojë Garancinë Bankare me depozitë. Nëse ka rënie në të gjithë industrinë e institucioneve financiare, Platforma e Alokimit mund të hetojë se cilat janë standardet e reja dhe, nëse konsiderohet e nevojshme, të ulë vlerësimin e kërkuar për një periudhë të kufizuar kohore, duke informuar OST-të, të cilat më pas do të informojnë NRA-të përkatëse."

Neni 8

Nxjtja e veprimeve dhe pasojat e shkurtimit të të Drejtave të Transmetimit Afatgjatë

Neni 56 (Nxjtja e veprimeve dhe pasojat e shkurtimit të të Drejtave të Transmetimit Afatgjatë) e HAR do të ndryshohen si më poshtë:

1. në pikën 3 do të lexohet: "3. Të Drejtat e Transmetimit Afatgjatë mund të reduktohen pas fiximit të Afatit të Ditës në Avancë në përputhje me legjislacionet kombëtare në fuqi "; dhe
2. paragrafi 5 do të lexohet: "5. Në rast reduktimi, Pjesëmarrësi i Regjistruar që preket ka të drejtë të marrë rimbursim ose kompensim sipas:
 - (a) Neni 10 (fiksimi i Afatit të Ditës Avancë) i këtij Aneksi (në vend të rregullave të përcaktuara në Nenin 58 (fiksimi i Afatit të Ditës Avancë të HAR));
 - (b) Neni 11 (Kompensimi për kufizimet për të siguruar që operacioni të mbetet brenda Kufijve të Sigurisë Operacionale përpara Fiksimit të Afatit të Ditës Avancë) të këtij Aneksi (në vend të rregullave të përcaktuara në Nenin 59 (Kompensimi për kufizimet për të siguruar që operacioni të mbetet brenda Kufijve të Sigurisë Operacionale përpara Afatit Përfundimtar) e HAR);
 - (c) Neni 12 (Rimbursimi për shkurtimet për shkak të Forcës Madhore të situatës emergjente përpara Fiksimit të Afatit të Ditës Avancë)) i këtij Aneksi (në vend të rregullave të përcaktuara në nenin 60 (Rimbursimi ose kompensimi për shkurtimet për shkak të Forcës Madhore të situatës emergjente përpara Fiksimit të Afatit të Ditës Avancë) e HAR)); dhe
 - (d) Neni 13 (Rimbursimi ose kompensimi për reduktimet për shkak të Forcës Madhore të situatës emergjente pas Fiksimit të Afatit të Ditës Avancë) të këtij Aneksi (në vend të rregullave të përcaktuara në Nenin 61 (Rimbursimi ose kompensimi për kufizimet për shkak të Forcës Madhore të situatës emergjente pas Fiksimit të Afatit të Ditës Avancë) të HAR)".

Neni 9

Procesi dhe njoftimi i reduktimit

Neni 57 (Procesi dhe njoftimi i reduktimit) i HAR do të ndryshohet për tu lexuar si më poshtë:
Në pikën 3 do të lexohet: “3. Përshkrimi i ngjarjes shkaktuese duhet të përfshijë informacion mbi kufirin(jtë) e saktë të sigurisë operationale që pritet të mos respektohen në mungesë të reduktimit, OST-në (të) që kërkojnë reduktimin dhe pse masat alternative nuk janë të mjaftueshme për të shmangur shkeljen e pritshme të kufirit(jve) të sigurisë operationale. Nëse ky informacion nuk është në dispozicion në të njëjtën kohë me informacionin e reduktimit në lidhje me të Drejtat të Transmetimit Afatgjatë të prekura dhe vëllimin e prekur në MW në orë për çdo periudhë të interesuar, OST-të do të paraqesin një njoftim të parë me informacionin në dispozicion dhe do të përditësojnë informacionin e reduktimit duke përfshirë detajet e kërkuara në lidhje me ngjarjen shkaktuese brenda 72 orëve pas njoftimit fillestar ”.

Neni 10

Fiksimi i Afatit të së Ditës Avancë

Neni 58 (Fiksimi i Afatit të Ditës Avancë) i HAR do të ndryshohet për tu lexuar si më poshtë:
"Platforma e alokimit do të publikojë në faqen e saj të internetit dhe do të marrë parasysh për llogaritjen e kompensimit për shkurtimin e të Drejtave të Transmetimit Afatgjatë fiksimin e afatit të ditës avancë, , siç propozohet nga OST-të përkatëse dhe miratohet nga NRA-të e interesuara".

Neni 11

Kompensimi për kufizime për të siguruar që operimi mbetet brenda Kufijve të Sigurisë Operationale përpara Fiksimit të Afatit të Ditës Avancë

Neni 59 (Kompensimi për kufizime për të siguruar që operimi mbetet brenda Kufijve të Sigurisë Operationale përpara Fiksimit të Afatit të Ditës Avancë) i HAR do të ndryshohet për tu lexuar si më poshtë:

1. pika 1 do të lexohet: "1. Në rastet e shkurtimit për të siguruar që operimi mbetet brenda Kufijve të Sigurisë Operationale para Fiksimit të Afatit të Ditës Avancë, kompensimi për çdo orë të prekur dhe Pjesëmarrës të Regjistruar do të llogaritet si të Drejta të Transmetimit Afatgjatë në MW në orë, që korrespondon me diferencën midis të Drejtave të Transmetimit Afatgjatë të Alokuar të mbajtura nga Pjesëmarrësi i Regjistruar para dhe pas shkurtimit, të shumëzuar me Çmimin Marxhinal të ankandit fillestar." ";
2. pikat 2, 3, 4 nuk zbatohen.

Neni 12

Rimbursimi ose kompensimi për shkurtime për shkak të Forcës Madhore ose situatës emergjente pas Fiksimit të Afatit të Ditës Avance

Neni 60

(Rimbursimi për reduktimet për shkak të Forcës Madhore përpara Afatit të Dakortësisë së Ditës në Avancë) i HAR do të ndryshohet për të lexuar si vijon: "Në rastin e Forcave Madhore para Afatit të Dakortësisë së Ditës në Avancë, mbajtësit e të drejtave të transmetimit afatgjatë të reduktuara, do të kenë të drejtë të marrin një rimbursim të barabartë me çmimin e të drejtave të transmetimit afatgjatë të vendosura gjatë Procesit të Alokimit të Të Drejtave të Transmetimit Afatgjatë, të cilat për çdo orë të prekur dhe Pjesëmarrës të Regjistruar do të llogariten si Të Drejta të Transmetimit Afatgjatë në MW për orë që korrespondon me diferencën midis Të Drejtave të Transmetimit Afatgjatë të alokuara të mbajtura nga Pjesëmarrësi i Regjistruar para dhe pas reduktimit shumëzuar me Çmimin Margjinal të Ankandit Fillestar."

Neni 13

Rimbursimi ose kompensimi për shkurtime për shkak të Forcës Madhore ose situatës emergjente pas Fiksimit të Afatit të Ditës Avance

Neni 61 (Rimbursimi ose kompensimi për shkurtime për shkak të Forcës Madhore ose situatës emergjente pas Fiksimit të Afatit të Ditës Avance) të HAR do të ndryshohet si me poshte: "Në rast të Forcës Madhore ose situatave emergjente pas Fiksimit të Afatit të Ditës Avance, mbajtësit e të Drejtave të Transmetimit Afatgjatë të shkurtoar, do të kenë të drejtën të marrin një rimbursim të barabartë me çmimin e të Drejtave Afatgjata të Transmetimit Afatgjatë të vendosur gjatë Procesit të Alokimit të të Drejtave të Transmetimit, i cili për çdo orë të prekur dhe Pjesëmarrës të Regjistruar, do të llogaritet si të Drejta të Transmetimit Afatgjatë në MW në orë që korrespondon me diferencën midis të Drejtave të Transmetimit Afatgjatë të alokuara të mbajtura nga Pjesëmarrësi i Regjistruar para dhe pas kufizimit, të shumëzuar me Çmimin Margjinal të Ankandit fillestar."

Neni 14

Faturimi dhe kushtet e pagesës

Neni 65 (Faturimi dhe kushtet e pagesës) i HAR do të ndryshohet si më poshtë:

1. paragrafi 1 do të lexohet: "1. Pagesat duhet të shlyhen para fillimit të Periudhës së Produktit, nëse afatet kohore të Ankandit e lejojnë këtë. Nëse produkti i Kapacitetit Ndër-Zonal ka një kohëzgjatje prej më shumë se një (1) muaj, çdo këst mujor do të zgjidhet në muajin e dytë (2) përpara muajit të dorëzimit, deri në afatin e përcaktuar në Kalendarin e Ankandit, të publikuar në faqen e internetit të Platformës së Alokimit.";

2. paragrafi 2 do të lexohet: "2. Platforma e Alokimit do të lëshojë fatura për pagesat për të gjitha të Drejtat e Transmetimit Afatgjatë në baza mujore në përputhje me Kalendarin e Ankandit, të publikuar në faqen e internetit të Platformës së Alokimit.";
3. paragrafi 5 do të lexohet: "5. Në rastet e shkurtimit të të Drejtave të Transmetimit Afatgjatë, ose kthimit të të Drejtave të Transmetimit afatgjatë sipas nenit 40 ose shpërblimit të të Drejtave të Transmetimit Afatgjatë sipas nenit 48, Pjesëmarrësi i Regjistruar do të lëshojë faturën në Platformën e Alokimit dhe do ta dorëzojë atë në rrugë elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Pavarësisht sa më lart, pagesat që do të kreditohen për Pjesëmarrësit e Regjistruar mund të shlyhen përmes mekanizmit të vetëfaturimit, i cili do të lejojë që Platforma e Alokimit të lëshojë fatura në emër dhe për llogari të Pjesëmarrësve të Regjistruar.";
4. paragrafët 6 dhe 7 nuk do të zbatohen;
6. paragrafi 9 do të lexohet: "9. Pjesëmarrësi i regjistruar do të shlyejë detyrimet e pagesës që rrjedhin nga paragrafi 3 ose paragrafi 8 i nenit 65 të këtyre Rregullave të Alokimit, brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së lëshimit të faturës."";
7. paragrafët 10 dhe 11 nuk do të zbatohen;
8. pika 12 do të lexojë: "12. Platforma e Alokimit do të shlyejë detyrimet e pagesës që rezultojnë nga paragrafi 5 ose paragrafi 8 i nenit 65 të këtyre Rregullave të Alokimit, brenda njëzet (20) Ditëve të Punës pas datës së marrjes së faturës."; dhe
9. Pika 15 do të lexohet: "15. Të gjitha tarifat bankare do të mbulohen nga Pjesëmarrësi i Regjistruar.".

Neni 19

Ligji rregullues

Article 77 (Ligji rregullues) i HAR do të ndryshohet për tu lexuar si më poshtë: "Këto Rregulla Alokimi do të rregullohen nga dhe interpretohen në të gjitha aspektet, në përputhje me ligjin e Belgjikës, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes "".

Shtojca 1

Lista e kufijve të Zonës së Ofertimit ku aplikohet HAR, përfshirë informacionin mbi llojin e të Drejtave Afatgjatë të Transmetimit të alokuara

Lista e kufijve të Zonës së Ofertimit dhe/ose nëngrupet e tyre të interkonektorëve	Lloji i Të Drejtave Afatgjata të Transmetimit	
Lista e OST përgjegjës		
Kroacia (HR) HOPS	◇ Bosnja dhe Hercegovina (BiH) NOS BiH	PTRs
Bosnja dhe Hercegovina (BiH) NOS BiH	◇ Mali i Zi (ME) CGES	PTRs
Mali i Zi (ME) CGES	◇ Shqipëria (AL) OST	PTRs
Shqipëria (AL) OST	◇ Greqia (GR) IPTO	PTRs
Greqia (GR) IPTO	◇ Maqedonia e Veriut (MK) MEPSO	PTRs
Greqia (GR) IPTO	◇ Turqia (TR) TEIAS	PTRs
Shqipëria (AL) OST	◇ Kosova (XK) KOSTT	PTRs
Kosova (XK) KOSTT	◇ Mali i Zi (ME) CGES	PTRs

Kosova (XK) KOSTT	◇	Maqedonia e Veriut (MK) MEPSO	PTRs
-----------------------------	---	---	------

Kjo listë e kufijve të Zonës së Ofertimit në të cilën aplikohet HAR, duke përfshirë informacionin për llojin e të Drejtave të Transmetimit Afatgjatë mund të ndryshohet ose të plotësohet në përputhje me dispozitat e Nenit 2, do të zbatohen (Data ne fuqi dhe aplikimi) i kësaj Shtojce Specifike për kufijtë e Zonës së Ofertimit të mirembajtur nga SEE CAO.

SHTOJCA 2

Lista e kufijve të Zonës së Ofertimit ku Kodi i Regjistrimit të ACER i caktuar nga Agjencia Evropiane për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) është parakusht për pjesëmarrje në procesin e alokimit.

Lista e kufijve të Zonës së Ofertimit		
Kroacia (HR) HOPS	◇	Bosnja dhe Hercegovina (BiH) NOS BiH

SEE CAO

Rregullat për Alokimin e Kapacitetit ditor eksplicit në zonat ofruese kufitare të ofruar nga SEE CAO

(“Rregullorja e Ankandit”)

Versioni 2.0



Përmbajtja

Përmbajtja

Përmbajtja		
Kapitulli 1	5
Neni 1	Subjekti dhe qëllimi.....	5
Neni 2	Përkufizime dhe interpretim.....	Error! Bookmark not defined.
Neni 3	Platforma e Alokimit	9
Neni 4	Data efektive dhe aplikimi.....	10
Kapitulli 2	11
Neni 5	Dispozita të përgjithshme	11
Neni 6	Konkluzion i marrëveshjes së pjesmarrjes	11
Neni 7	Forma dhe përmbajtja e marrëveshjes së pjesmarrjes	12
Neni 8	Dërgimi i informacionit	13
Neni 9	Garancitë.....	14
Neni 10	Llogari biznesi e dedikuar	15
Neni 11	Pranimi i rregullave të sistemit të informacionit	15
Neni 12	Kostot në lidhje me marrëveshjen e pjesmarrjes	15

Neni 13	Refuzim i aplikimit.....	15
Neni 14	Akses në programin e ankandit	16
Neni 15	Konkluzion nga detyrime shtese financiare.....	17
Neni 16	Kërkesat ligjore dhe rregullatore	17
Kapitulli 3	18
Neni 17	Dispozita të përgjithshme	18
Neni 18	Forma e depozitave cash.....	18
Neni 19	Forma e garancisë bankare	19
Neni 20	Vlefshmëria dhe rinovimi i garancisë bankare	20
Neni 21	Limiti i kreditit	20
Neni 22	Modifikime të kolateraleve.....	21
Neni 23	Incident kolaterali	22
Neni 24	Kërkes për kolaterale	22
Kapitulli 4	23
Neni 25	Dispozita të përgjithshme për ankande.....	23
Neni 26	Kohëzgjatja e alokimit të kapacitetit dhe forma e produktit	23
Neni 27	Specifikime të ankandit	23
Neni 28	Paraqitja e ofertave	24
Neni 29	Regjistrimi i ofertës	25
Neni 30	Oferta e paracaktuar.....	26
Neni 31	Proceduar e sigurisë për Ofertat e Paracaktuara.....	26
Neni 32	Verifikimi i limitit të kredisë.....	26
Neni 33	Njoftimi i rezultateve të ankandit	28
Neni 34	Njoftimi i i rezultateve të ankandit	29
Kapitulli 5	31
Neni 35	Parimet e përgjithshme	31
Neni 36	Nominimi i të drejtave të transmetimit fizik	31
Neni 37	Dokumenti i të drejtave të kapacitetit.....	32
Neni 38	Rezervimi i të drejtave të transmetimit fizik për shërbime balancuese.....	32
Kapitulli 6	33
Neni 39	Dispozita të përgjithshme	33
Neni 40	Procedura rezervë për shkëmbimin e të dhënave	34
Neni 41	Procedura rezervë pëe ankandin	35

Neni 42	Ankandi rezervë.....	36
Neni 43	Anullim ankandi	36
Kapitulli 7	32
Neni 44	Eventet e shkaktuara si pasojë e kufizimit të të Drejtave Ditore të Transmetimit.....	37
Neni 45	Procesi dhe njoftimi i kufizimit.....	38
Kapitulli 8	38
Neni 46	Parimet e përgjithshme	38
Neni 47	Llogaritjet e shumave të duhura	38
Neni 48	Tatimi Bruto	39
Neni 49	Kushtet e pagesës dhe faturimit.....	39
Neni 50	Pagesat kontestuese	41
Neni 51	Pagesat e vonuara dhe incidente në pagesë	42
Kapitulli 9	42
Neni 52	Kohëzgjatja dhe amendimi i rregullave të alokimit.....	42
Neni 53	Detyrimi.....	43
Neni 54	Zgjidhja e mosmarrveshjeve.....	44
Neni 55	Pezullim i marrëveshjes së pjesmarrjes	46
Neni 56	Nderprerje e marrëveshjes së pjesmarrjes	47
Neni 57	Forcë madhore	48
Neni 58	Njoftime.....	49
Neni 59	Konfidencialiteti	50
Neni 60	Detyrim dhe nënkontraktim.....	51
Neni 61	Ligji qeverisës	52
Neni 62	Gjuha	52
Neni 63	Asete intelektuale	52
Neni 64	Mardhëniet e palëve.....	52
Neni 65	Asnje e drejte për palën e tretë	52
Neni 66	Dokument i dorëheqjes.....	53
Neni 67	Marrëveshja	53
Neni 68	Procedurat Ligjore	53
Neni 69	Dispozita në kontrate.....	54
Shtojce 1	5

Kapitulli 1

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Subjekti dhe qëllimi

1. Këto rregulla alokimi përmbajnë termat dhe kushtet për Alokimin eksplisit të së drejtave të transmetimit ditor në zonat ofruese kufitare të specifikuara në Apendix1. Duhet kuptuar që pjesmarrësit e regjistruar do të aderojnë në këto rregulla duke nënshkruar marrëveshjen e pjesëmarrjes. Në vecanti, rregullat e alokimit përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve të regjistruar si dhe kërkesat për pjesëmarrjen në ankande. Gjithashtu, ato përshkruajnë procesin e ankandit duke përfshirë përcaktimin e cmimit marxhinal si rezultat i ankandit dhe proceset për shkurtimin e të drejtave të transmetimit ditor dhe faturimi/pagesa.
2. Në rast se Operatorët e Sistemit të Transmetimit paraqesin bashkimin e tregut si metodë alokimi të kapacitetit në një zonë ofruese kufitare të listuar në Apendix 1, atëhere zona përkatëse ofruese kufitare përjashtohet nga këto rregulla alokimi, në princip që nga koha që zbatohet ky bashkim tregu përkatës. Ky ndryshim kërkon vetëm vendimin e Operatorëve përkatës të Sistemit të Transmetimit dhe i nënshtrohet miratimit të autoriteve rregullatore përkatëse përpara se të bëhet e vlefshme.

3. Ankandet i referohen vetëm kapacitetit ndërkufitar dhe pjesëmarrësit e regjistruar nuk mund të kërkojnë asnjë të drejtë tjetër në lidhje me të drejtat e transmetimit ditor që i janë alokuar atyre në përputhje me dispozitat e këtyre rregullave alokimi.
4. Eshtë vënë re se operimi i platformës së alokimit mbulon zonën ku operojnë OST-të e bashkimit europian, Operatorët e Sistemit të Transmetimit nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë si dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit nga shtetet e tjera. Referencat për (a) TSO ose Operatorin e Sistemit të Transmetimit përfshijnë referencat ndaj OST-ve të Bashkimit Europian, Operatorët e Sistemit të Transmetimit nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë si dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit nga shtetet e tjera dhe (b) Autoritetet Rregullatore Kombëtare ose NRA-të përfshijnë referencat ndaj NRA-ve të BE-së dhe autoriteteve përkatëse rregullatore kombëtare në palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe vëndeve të tjera përkatëse.

Neni 2

Përkufizime dhe Interpretim

1. Termat e kapitalizuara të përdorura në këto rregulla Alokimi do të kenë kuptimin që ju është dhënë në Nenin 2 të Rregullores (EC) 2019/943, Nenin 2 të Rregullores (EC) 714/2009, Nenin 2 të Rregullores (EC) 2013/543, Nenin 2 të Rregullores (EU) 2015/1222, Nenin 2 të Rregullores (EC) 2019/944 Neni 2 i Direktivës 2009/72/EC dhe në Rregulloren (EU) 2016/1719.
2. Përvec kësaj, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

Antarësohem do të thotë në lidhje me cdo person, cdo person tjetër që direkt ose indirekt kontrollon, kontrollohet nga ose është nën kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të përshbashkët me atë person, ku kontrolli është përcaktuar në Rregulloren e BE-së (EC) Nr. 139/2004 të datës 20 Janar 2004 mbi kontrollin e përqëndrimeve ndërmjet sipërmarrjeve ose sic mund të jetë legjislacioni i ngjashëm kombëtar;

Platforma e Alokimit do të thotë një entitet i emëruar dhe i komisionuar nga Operatorët e Sistemit të Transmetimit të përgjegjshëm për të vepruar në emër të tyre dhe në emër të vet duke qënë një platformë e vetme alokimi ose platformë rajonale për atribimin e kapacitetit ditor ndërkufitar përmes ankandeve sic janë të përcaktuara në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes;

Rregullat e Alokimit nënkuptojnë rregullat për alokimin eksplicit të kapaciteteve ditore në zonat kufitare ofruese të ofruara nga SEE CAO;

Programi i Ankandit nënkupton sistemin e teknologjisë së informacionit që përdoret nga platforma e alokimit për të kryer ankandet dhe për të lehtësuar procedura të tjera të përshkruara në këto rregulla alokimi;

Specifikimi i Ankandit nënkupton një listë të karakteristikave specifike të një ankandi të vecantë, duke përfshirë natyrën e produkteve të ofruara dhe datat përkatëse;

Garancia Bankare nënkupton një letër gatishmërie kredie të pakushtëzuar dhe të parevokueshme ose letër garancie të lëshuar nga një bankë;

Oferta nënkupton një cift të caktuar të sasisë së ofertës dhe cmimit të ofertës të ofruar nga një pjesëmarrës i regjistruar i cili merr pjesë në ankand;

Cmimi i ofertës nënkupton cmimin që një pjesëmarrës i regjistruar është i gatshëm ta paguajë për një (1) MW dhe orë të drejtave të transmetimit ditor;

Sasia e ofertës nënkupton shumën e të dhëanve ditore të transmetimit në MW të kërkuara nga një pjesëmarrës i regjistruar;

Periudha e Ofertimit nënkupton periudhën kohore brënda së cilës pjesëmarrësit e regjistruar që dëshirojnë të marrin pjesë në ankand mund të dorëzojnë ofertat e tyre;

Llogaria e Biznesit nënkupton një llogari të dedikuar të depozitave të hapur nga Platforma e Alokimit me qëllim sigurimin e kolateraleve në formën e depozitës së parave nga Pjesëmarrësit e Regjistruar, e cila mund të përdoret për pagesat nga pjesëmarrësi i regjistruar;

Identifikimi i Marrëveshjes së Kapacitetit(CAI) do të thotë një kod unik identifikimi i caktuar për secilën të drejtë të transmetimit fizik nga programi i ankandit gjatë ankandit. Kodi i identifikimit përdoret edhe kur përdorimi i të drejtës së transmetimit fizik është nominuar nga Operatorët e Sistemit të Transmetimit;

Limitimi i Kreditit nënkupton shumën e kolateraleve që mund të përdoren për të mbuluar çdo dërgim të ofertës në ankandet e mëpasshme dhe nuk përdoret për detyrimet e papaguara të pagesës;

Alokim i kapacitetit ditor nënkupton atributimin e kapacitetit ndërkufitar ditor nëpërmjet një ankandi;

Te drejtat e Transmetimit ditor për qëllimet e këtyre rregullave të alokimit nënkupton një të drejtë të transmetimit fizik e fituar në Alokimin e Kapacitetit Ditor;

Kodi EIC nënkupton Skemën e Kodimit të Identifikimit të Energjisë e ENTSO-E për identifikimin e palëve në një tregti ndërkufitare;

Procedura e sigurisë nënkupton procesin me anë të së cilës Platforma e Alokimit i atribuon kapacitetet një pjesëmarrësi të regjistruar në rast se është futur në procedurën e sigurisë.

Forcë madhore nënkupton cdo ngjarje apo situatë të paparashikueshme ose të pazakontë përtej kontrollit të arsyeshëm të një pale dhe/ose të Operatorëve përkatës të Sistemit të Transmetimit dhe jo për shkak të një gabimi të palës dhe/ose të Operatorëve përkatës se Sistemit të Transmetimit, të cilat nuk mund të shmangen ose të tejkalohen me largpamësi të arsyeshme dhe zell, të cilat nuk mund të zgjidhen nga masa që janë nga një pikëpamje teknike, financiare apo ekonomike të arsyeshme për palën dhe/ose Operatorët e Sistemit të Transmetimit, që tashmë ka ndodhur dhe është objektivisht i verifikueshëm dhe që e bën të pamundur për palën dhe/ose Operatorët e Sistemit të Transmetimit të përmbushin përkohësisht ose përgjithmonë detyrimet e saj;

Rregullat e Sistemit të Informacionit nënkuptojnë termat dhe kushtet për akses dhe përdorim të programit të ankandit nga pjesëmarrësit e regjistruar sic është publikuar në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;

Cmimi Marxhinal nënkupton cmimin e përcaktuar në ankand të vecantë që duhet të paguhet nga të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar për cdo MW dhe orë të së drejtës të transmetimit fizik të fituar;

Autoritetet Rregullatore Kombëtare nënkuptojnë autoritetet rregullatore të përmendura në Nenin 35(1) të Direktivës 2009/72/EC ose sic mund të jetë legjislati i ngjashëm kombëtar;

Marrëveshja e Pjesëmarrjes do të thotë marrëveshja me anë të së cilës palët marrin përsipër të pajtohen me termat dhe kushtet për alokimin e kapacitetit, të përcaktuara në këto rregulla alokimi;

Pala/Palët nënkuptojnë Platformën e Alokimit dhe/ose pjesëmarrësin e regjistruar të referuar individualisht si palë ose kolektivisht si palë.

E Drejta e Transmetimit Fizik është e drejta që i jep të drejtën mbajtësit të tij të transferojë fizikisht një vëllim të caktuar të energjisë elektrike në një periudhë të caktuar kohore ndërmjet dy zonave ofruese sipas një drejtimi të caktuar;

Periudha e Produktit nënkupton kohën dhe datën në të cilën fillon e drejta për të përdorur të Drejtën e Transmetimit Ditor dhe kohën dhe datën në të cilën përfundon e drejta për ta përdorur të Drejtën e Transmetimit Ditor;

Pjesëmarrësi i Regjistruar do të thotë një pjesëmarrës tregu i cili ka hyrë në një marrëveshje pjesëmarrjeje me platformën e alokimit;

Dokumenti i të drejtave nënkupton një dokument që përmban informacion të sasisë maksimale të të drejtave të transmetimit fizik të alokuar (të identifikuar nga CAI) e cila mund të nominohet nga një pjesëmarrës tregu për zonën kufitare ofruese për ditë, orë dhe për drejtim, duke marrë parasysh vëllimin e të dhënave ditore të transmetimit fillimisht të blera dhe cdo shkurtime të mundshëm që mund të ketë ndodhur përpara lëshimit të Dokumentit të të Drejtave;

Ditë pune nënkupton ditët kalendarike nga e hëna deri të premten, me përjashtim të ditëve të festave zyrtare sic janë përcaktuar në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;

Orët e Punës nënkupton orët e përcaktuara në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes;

3. Në këto rregulla alokimi, duke përfshirë anexet e saj, përvec kësaj konteksti kërkon gjithashtu:

- a) Cdo referencë në fjalën zonë ofruese kufitare mund të mbulojë të gjithë interkonektorët kolektivisht ose vetëm një ose një grup interkonektorësh në këtë zonë ofruese kufitare sic është e përcaktuar në Aneksin 1 të këtyre rregullave të alokimit;
- b) Njëjës tregon shumësin dhe anasjelltas;
- c) Referencat për një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë e tjera;
- d) Tabela e përmbajtjeve, krerët dhe shembujt futen për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e Rregullave të Alokimit;
- e) Fjala “përfshirë” dhe variacionet e saj duhet të interpretohen pa kufizim;
- f) Cdo referencë në legjislacion, rregullore, direktivë, urdhër, instrument, kod ose ndonjë miratim tjetër duhet të përfshijë cdo modifikim, zgjatje ose ri-miratimin e atij që është në fuqi;
- g) Cdo referencë në një marrëveshje ose dokument tjetër, ose ndonjë vepër ose instrument tjetër duhet të interpretohet si referencë në atë marrëveshjen tjetër, ose atë dokument, atë vepër ose ndonjë instrument tjetër të përmisuar, të ndryshuar, plotësues, të zëvendësueshëm ose të ri-aktualizuar kohë pas kohe;
- h) Një referencë në kohë është referencë në kohën CET/CEST, përvec rastit nëse specifikohet ndryshe; dhe

- i) Kur Platforma e Alokimit kërkohet që të publikojë cdo informacion sipas këtyre rregullave të alokimit, ai duhet ta bëjë këtë duke i vënë në dispozicion informacionin ose të dhënat në faqen e saj të internetit ose nëpërmjet programit të ankandit.

Neni 3

Platforma e Alokimit

1. Platforma e Alokimit duhet të kryejë funksionet e alokimit në përputhje me këto rregulla alokimi, legjislacionin e aplikueshëm të Bashkimit Europian ose aktet ligjore në fuqi të Komunitetit të Energjisë dhe legjislacionin kombëtar të zbatueshëm të një ose më shumë vendeve të zonës ofruese kufitare.
2. Për qëllimet e këtyre rregullave të alokimit, Platforma e Alokimit do të jetë pala që nënshkruan Marrëveshjen e Pjesëmarrjes me Pjesëmarrësin e Regjistruar.

Neni 4

Data efektive dhe aplikimi

1. Këto rregulla alokimi do të hyjnë në fuqi në përputhje me regjimin rregullator të aplikueshëm dhe në datën e shpallur nga platforma e alokimit.
2. Këto rregulla alokimi zbatohen për alokimin e kapaciteteve ditore për të drejtat e transmetimit ditore me periudhën e dorëzimit nga 01 Janar 2023.
3. Aktivitetet e Platformës së Alokimit mbulojnë juridiksione të OST-ve nga Bashkimi Europian, OST-të nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe nga një ose më shumë vende të tjera. Referencat për (a) OST ose Operatorin e Sistemit të Transmetimit përfshijnë referencat për OST-të e BE-së, operatorët e sistemit të transmetimit nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë si dhe operatorët e sistemit të transmetimit nga cdo vend tjetër në të cilin shërbimet ofrohen nga platforma e alokimit dhe (b) NRA ose Autoriteti Rregullator Kombëtar përfshijnë referenca tek NRA-të e Bashkimit Europian, ose NRA-të nga palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ose rregullatorët e vendeve të tjera të cilat kanë juridiksion mbi OST-në përkatëse ose Platformën e Alokimit.

Kapitulli 2

Kërkesat dhe procesi për pjesëmarrjen në Ankande

Neni 5

Dispozita të përgjithshme

1. Pjesëmarrësit e tregut mund të fitojnë një të drejtë transmetimi ditore vetëm nga pjesëmarrja në ankande.
2. Pjesëmarrja në ankande kërkon që pjesëmarrësi i tregut:
 - a) të përfundojë një marrëveshje pjesëmarrjeje të vlefshme dhe efektive në përputhje me nenet 6 deri në 13; dhe
 - b) të ketë akses në programin e ankandit në përputhje me nenin 14.
3. Pjesëmarrja në ankande kërkon që pjesëmarrësi i tregut, përveç kushteve të parashtruara në paragrafin e mëparshëm, gjithashtu të plotësojë dhe kushtet e mëposhtme:
 - a) Ata të përputhen me kërkesat për sigurimin e kolateralit sic është specifikuar në kapitullin 3; dhe
 - b) Ata pranojnë kushte financiare shtesë sipas nevojës në përputhje me nenin 15.
4. Në çdo rast, pjesëmarrësit e tregut duhet të përmbushin detyrimet sic janë specifikuar kapitujt përkatës të këtyre rregullave të alokimit.

Neni 6

Konkluzion i marrëveshjes së pjesëmarrjes

1. Të paktën nëntë (9) ditë pune, përpara pjesëmarrjes së parë në ankand, çdo pjesëmarrës tregu mund të aplikojë për tu bërë palë në një marrëveshje pjesëmarrjeje duke dërguar në platformën e alokimit dy (2) kopje të nënshkuara të marrëveshjes së pjesëmarrjes, në rast të nënshkrimit (eve) me shkrim dore siç publikohet në faqen e internetit të platformës së alokimit, bashkë me të gjitha informatat dhe dokumentat e plotësuar siç duhet, të përcaktuara në nenet 7 deri 14. Marrëveshja e Pjesëmarrjes do të nënshkruhet në mënyrë alternative me nënshkrim (e) me shkrim dore ose nënshkrim (e) të kualifikuar/a elektronik/e (QES). Platforma e Alokimit do të vlerësojë plotësinë e informacionit të paraqitur në përputhje me nenet 8 dhe 11 brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e Marrëveshjes së pjesëmarrjes të plotësuar dhe nënshkuar.
2. Platforma e Alokimit duhet që përpara skadimit të afatit të shtatë (7) ditëve të punës, tju kërkojë pjesëmarrësve të tregut që të ofrojnë çdo informacion të papërfunduar të cilin

pjesëmarrësi i tregut nuk e ka paraqitur në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes. Me marrjen e informacionit të papërfunduar, Platforma e Alokimit brënda një tjetër 7 (shtatë) ditëshi pune, shtëse do të shqyrtojë informacionin dhe informojë pjesëmarrësin e tregut nëse kërkohet ndonjë informacion i mëtejshëm.

3. Pasi platforma e alokimit ka marrë të gjithë informacionin e nevojshëm, ai do të kthejë një kopje të marrëveshjes së pjesëmarrjes të nënshkruar prej tij tek pjesëmarrësi i tregut pa pasur vonesa të panevojshme. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Pjesëmarrjes nga Platforma e Alokimit nuk duhet të tregojë vetë pajtueshmëri me ndonjë kusht tjetër të vendosur në këto rregulla të alokimit për pjesëmarrjen në ankandet. Marrëveshja e Pjesëmarrjes hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Platforma e Alokimit.
4. Është përgjegjësi e çdo pjesëmarrësi tregu që të garantojë përputhjen me legjislacionin kombëtar, dhe kur është i aplikueshëm me legjislacionin e Bashkimit Europian ose me akte ligjore të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë kërkesat e çdo autoriteti kompetent përkatës dhe të marrë të gjitha autorizimet e nevojshme në lidhje me pjesëmarrjen e tij në ankand.

Neni 7

Forma dhe përmbajtja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes

1. Forma e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes dhe kërkesat për plotësimin e tij duhet të publikohen nga Platforma e Alokimit dhe mund të ndryshohet herë pas here nga Platforma e Alokimit pa ndryshuar asnjë term dhe kushtet e specifikuar në këto Rregulla Alokimi, përveç rastit nëse është e përcaktuar ndryshe në këto rregulla Alokimi.
2. Minimalisht, Marrëveshja e Pjesëmarrjes do të kërkojë pjesëmarrësit të tregut të:
 - a) Të sigurojë të gjithë informacionin e nevojshëm në përputhje me nenin 8 dhe nenin 11; dhe
 - b) Të pranojnë që do jenë të detyruar nga dhe në pajtim me këto Rregulla të Alokimit.
3. Asgjë në këto rregulla të alokimit nuk do të parandalojë Platformën e Alokimit dhe Pjesëmarrësin e Regjistruar që të bie dakort me rregullat shtesë të Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, jashtë fushës së veprimit të këtyre Rregullave të Alokimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në pjesëmarrjen në Alokimet afatgjata ose ato ditore eksplicite ose ndonjë proces sigurie për Alokimin Implicit të një dite përpara/në avancë.
4. Në rastin e vështirësive të interpretimit, kontraditës osë dykuptimësinë midis këtyre Rregullave të Alokimit dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, do të mbizotërojë teksti i Rregullave të Alokimit.

Neni 8

Dërgimi i Informacionit

1. Pjesëmarrësi i tregut duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm me Marrëveshjen tij të Pjesëmarrjes të plotësuar dhe nënshkruar:
 - a) emri dhe adresa e regjistruar e pjesëmarrësit të tregut duke përfshirë dhe adresën e e-mailit dhe numrin e telefonit të pjesëmarrësit të tregut për njoftime në përputhje me nenin 58.
 - b) nëse pjesëmarrësi i tregut është një person juridik nevojiten një ekstrakt i regjistrimit të pjesëmarrësit të tregut në regjistrin tregtar të autoritetit kompetent;
 - c) detajet e kontaktit dhe emrat e personave të autorizuar për të përfaqësuar pjesëmarrësin e tregut dhe funksionin e tyre;
 - d) numri i regjistrimit të TVSH-së së BE-së ose informacione të ngjashme të identifikimit tatimor kur TVSH-ja e BE-së nuk është e zbatueshme;
 - e) tatimet dhe taksat që duhet të merren parasysh për llogaritjet e faturave dhe kolateralit;
 - f) Kodi i Identifikimit të Energjisë (EIC);
 - g) informacionin e llogarisë bankare për pagesën për aplikuesin që do të përdoret nga Platforma e Alokimit për qëllimet e nenit 49 paragrafi 7.
 - h) personi i kontaktit për financat në lidhje me kolateralet, faturimin dhe çështjet e pagesës, si dhe detajet e tyre të kontaktit (email dhe numri i telefonit) për njoftimet kur kërkohet në këto Rregulla Alokimi në përputhje me nenin 58;
 - i) personi i kontaktit komercial dhe detajet e kontaktit (e-mail dhe numri i telefonit) për njoftime kur kërkohet në këto Rregulla të Alokimit në përputhje me nenin 58; dhe
 - j) personi i kontaktit operacional dhe detajet e kontaktit (e-mail dhe numri i telefonit) për njoftime kur kërkohet në këto Rregulla Alokimi në përputhje me nenin 58; dhe
 - (k) Kodi i Regjistrimit ACER (Kodi ACER) i caktuar nga Agjencia Evropiane për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) gjatë procesit të regjistrimit të pjesëmarrësve në treg me ARK-në, për pjesëmarrje në alokim në kufijtë e Zonës së Ofertimit të listuar në Shtojcën 2.
2. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të sigurojë që të gjitha të dhënat dhe informacionet e tjera që ai ofron tek Platforma e Alokimit në përputhje me këto Rregulla Alokimi (duke përfshirë informacionin në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes) janë dhe qëndrojnë të sakta dhe të

kompletuara në të gjitha aspektet materiale dhe duhet të njoftojë menjëherë Platformën e Alokimit për cdo ndryshim.

3. Një Pjesëmarrës i Regjistruar duhet të njoftojë Platformën e Alokimit nëse ka ndonjë ndryshim në informacion e paraqitur në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni, të paktën nëntë (9) ditë pune para se të hyjë në fuqi ndryshimi dhe kur kjo nuk është e mundur, pa vonesa pasi Pjesëmarrësi i Regjistruar të jetë në dijeni të ndryshimit.
4. Platforma e Alokimit do të konfirmojë regjistrimin e ndryshimit ose do të dërgojë një njoftim refuzimi të regjistrimit të ndryshimit tek pjesëmarrësi i regjistruar, të paktën shtatë (7) ditë pune pas pranimit të njoftimit përkatës për ndryshim. Konfirmimi ose njoftimi i refuzimit do të dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Nëse Platforma e Alokimit refuzon të regjistrojë këtë ndryshim, arsyeja duhet të paraqitet në njoftimin e refuzimit.
5. Ndryshimi bëhet i vlefshëm në ditën e dërgimit të konfirmimit tek Pjesëmarrësi i Regjistruar.
6. Nëse kërkohet informacion shtesë nga një Pjesëmarrës i Regjistruar si pasojë e një ndryshimi në këto Rregulla Alokimi, atëherë pjesëmarrësi i regjistruar duhet të paraqesë informacionin shtesë në Platformën e Alokimit brenda dymbëdhjetë (12) ditëve të punës pas kërkesës për një dorëzim të tillë nga Platforma e Alokimit.

Neni 9 **Garancitë**

1. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, pjesëmarrësi i tregut garanton që
 - a) nuk ka filluar asnjë procedurë që kërkon një gjykim të mospagesës ose falimentimin ose ndonjë lehtësi tjetër në bazë të cilitdo ligji falemintemimi ose mospagese ose nodnje ligji tjetër të ngjashëm që ndikon në të drejtat e kreditorëve;
 - b) nuk ka pasur asnjë mundësi mospagimi, falimentimi apo procedurë tjetër të ngjashme ligjore që prek të drejtat e kreditorëve në lidhje me aplikantin;
 - c) nuk ka filluar procedurat e likuidimit në lidhje me aplikantin; dhe
 - d) nuk ka detyrime të vonuara pagesash ndaj Platformës së Alokimit.

Neni 10 **Llogari Biznesi e Dedikuar**

Si pjesë e paraqitjes së informacionit në përputhje me Nenin 6 dhe Nenin 8, një Llogari e Dedikuar Biznesi vihet në dispozicion të Pjesëmarrësit të Tregut për qëllime të depozitimittë kolateralëve në para dhe/ose për qëllime të kryerjes së pagesave mbi bazën e përshkruar në nenin 49.

Neni 11

Pranimi i Rregullave të Sistemit të Informacionit

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, Pjesëmarrësi i Tregut pranon rregullat e aplikueshme të Sistemit të Informacionit, të ndryshueshme herë pas here ku publikohen në faqen e internetit të platformës së alokimit.

Neni 12

Kostot në lidhje me Marrëveshjen e Pjesëmarrjes

Të gjithë aplikantët për tu bërë Pjesëmarrës i Regjistruar dhe çdo pjesëmarrje e mëpasshme në ankand do të jetë në koston, shpenzimet dhe rrezikun e secilit. Platforma e Alokimit nuk do t'i përgjigjet asnjë personi për ndonjë kosto, dëm, apo shpenzim në lidhje me Pjesëmarrësin e Regjistruar që merr pjesë në ankand, përveç nëse është deklaruar qartë në këto Rregulla të Alokimit.

Neni 13

Refuzimi i Aplikimit

Platforma e Alokimit mund të refuzojë Marrëveshjen e Pjesëmarrësit të pjesëtarëve të tregut në kushtet e mëposhtme:

- (a) Kur aplikanti nuk ka paraqitur të përfunduar dhe të nëshkruar Marrëveshjen e Pjesëmarrësit në përputhje me nenet 6, 7 dhe 8; ose
- (b) Platforma e Alokimit ka ndërprerë më herët Marrëveshjen e Pjesëmarrjes me ankuesin si rezultat i shkeljes së marrëveshjes nga Pjesëmarrësi i Regjistruar në përputhje me nenin 56 (3) dhe (4), ose kur rrethanat që çojnë në ndërprerje nuk ekzistojnë më, ose platforma e alokimit është e bindur që kjo ndërprerje nuk do të ndodhë përsëri ose
- (c) Nëse lidhja e marrëveshjes me aplikuesin do të shkaktonte Platformës së Alokimit të shkelte ndonjë kusht të kërkesave ligjore ose rregullave të detyrueshme ose
- (d) Nëse ndonjë nga garancitë e pjesëmarrësit të regjistruar sipas nenit 9 nuk është i vlefshëm ose i rremë.
- (e) Nëse aplikanti është nën sanksione ekonomike dhe tregtare që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në Platformën e Alokimit.

Neni 14

Aksesi në Programin e Ankandit

1. Platforma e Alokimit duhet të sigurojë akses pa pagesë në programin e ankandit nëse plotësohen kërkesat e mëposhtme:

- (a) Pjesëmarrësi i Regjistruar ka nënshkruar dhe dorëzuar një formular të plotësuar të përfshirë në rregullat e Sistemit të Informacionit duke identifikuar personin/personat për të cilin do ti sigurohet llogaria e përdoruesit në Programin e Ankandit dhe
 - (b) Pjesëmarrësi i Regjistruar ka përmbushur kërkesat për vërtetimin sic është përcaktuar në rregullat e Sistemit të Informacionit publikuar nga Platforma e Alokimit. Kërkesa të tilla mund të përfshijnë, teknologji për qëllime të vërtetimit.
2. Platforma e Alokimit do të konfirmojë krijimin e llogarisë së përdoruesit ose mund t'i dërgojë një njoftim refuzimi Pjesëmarrësit të Regjistruar, jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas pranimit të formularit përkatës të nënshkruar dhe të plotësuar nga pjesëmarrësi i regjistruar. Deklarata e konfirmimit ose e refuzimit do të dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit.
 3. Platforma e Alokimit duhet të dërgojë në kohë njoftimin e refuzimit të arsyetuar në mënyrë të duhur, nëse kërkesat e listuara në paragrafin një (1) të këtij neni nuk janë përmbushur dhe nuk do të jepet akses në Programin e Ankandit.

Neni 15

Konkluzion nga detyrime shtese financiare

Platforma e Alokimit mund të zhvillojë dhe publikojë detyrime shtesë financiare për t'u pranuar nga pjesëtarët e regjistruar. Këto detyrime shtesë financiare mund të përfshijnë kushte për të mundësuar kolateral të përbashkët për procese të tjera të organizuara nga Platforma e Alokimit në përputhje me Marrëveshjen e Pjesëmarrjes, për sa kohë që këto kushte shtesë financiare përputhen me Rregullat e Alokimit.

Neni 16

Kërkesat Ligjore dhe Rregullatore

Është përgjegjësi e secilit Pjesëmarrës të Tregut që të garantojë përputhjen me legjislacionin Kombëtar, nëse është e zbatueshme, legjislacionin e Bashkimit European ose akteve ligjore të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë kërkesat e çdo autoriteti kompetent dhe të marrë të gjitha autorizimet e nevojshme në lidhje me pjesëmarrjen e saj në Ankand ose në përdorimin e të Drejtave të Transmetimit Ditor.

Kapitulli 3

Kolateralët

Neni 17

Dispozita të përgjithshme

1. Pjesëmarrësit e Regjistruar do të ofrojnë kolateral në mënyrë që të sigurohet pagesa në Platformën e Alokimit që rezulton nga ankandi i të Drejtave të Transmetimit Ditor.

Pagesat e tjera të mundshme janë pjesë e detyrimit financiar shtesë në përputhje me Nenin 15.

2. Do të pranohen vetëm format e mëposhtme të kolateralit:
 - (a) Garancia Bankare.
 - (b) Depozita në para në Llogari Biznesi të dedikuar.
3. Kolateralet mund të sigurohen në një nga format e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni ose në një kombinim të këtyre formave, me kusht që Platforma e Alokimit të ketë të drejtë si përfitues në kolateralin e plotë
4. Kufiri i kredisë do të jetë gjithmonë më i madh ose i barabartë me zero.
5. Kolateralet duhet të sigurohen në euro (€).

Neni 18

Format e depozitave cash

Për kolateralet që sigurohen në formën e një depozite cash në llogarinë e biznesit të dedikuar zbatohen kushtet e mëposhtme:

- (a) Paratë do të depozitohen në llogarinë e biznesit të dedikuar në një nga institucionet financiare të zgjedhura nga Platforma e Alokimit.
- (b) Llogaria e Biznesit e dedikuar do të jetë e hapur dhe do të përdoret gjithashtu për detyrimet shtesë financiare në përputhje me nenin 15.
- (c) Deri në tërheqjen e lejuar nga dispozita e mëposhtme e nenit 24, depozita në para në llogarinë e biznesit të dedikuar i përket Pjesëmarrësit të Regjistruar nëse nuk përcaktohet ndryshe në termat shtesë financiare në përputhje me nenin 15.
- (d) Tërheqjet nga llogaria e dedikuar e biznesit sipas nenit 22 dhe nenit 24 mund të bëhen vetëm në udhëzimin e Platformës së Alokimit.
- (e) Llogaria e Dedikuar e Biznesit mund të përdoret për vec kësaj për Settlement sic parashikohet në nenin 49; dhe
- (f) Interesi mbi shumën e depozituar në llogarinë e biznesit të dedikuar do të rritet në dobi të pjesëmarrësit të regjistruar, pas zbritjes së taksave dhe pagesave bankare nëse ka.

Forma e Garancis Bankare

1. Kolateralet që ofrohen në formën e garancisë bankare duhet të jenë në përputhje me specifikimet e mëposhtme:
 - (a) Garancia e Bankës do të sigurohet në formën e template që është e disponueshme në faqen e internetit të Platformës së Alokimit ku do të përditësohet herë pas here që në thelb ndjek modelin e templatit.
 - (b) Garancia e Bankës duhet të jetë e shkruar në gjuhën Angleze.
 - (c) Garancia Bankare mbulon të gjitha Ankandet e organizuara nga Platforma e Alokimit sipas kushteve shtesë financiare në përputhje me nenin 15.
 - (d) Garancia Bankare do të lejojë tërheqjen e pjesëshme dhe të shumëfishtë nga Platforma e Alokimit, deri në shumën maksimale të garantuar.
 - (e) Garancia Bankare do të sigurojë pagesën sipas kërkesës të Platformës së Alokimit. Gjithashtu nëse Platforma e Alokimit bën thirrje për garanci bankare, banka duhet të paguajë automatikisht pa ndonjë kusht tjetër me përjashtim të faturës së kërkesës dërguar me SWIFT përmes bankës ndërmjetëse që konfirmon se nënshkrimet në kërkesë duket se përputhen me ekzemplarën e mbajtur nga banka.
 - (f) Garancia bankare është e pakthyeshme, e pa kushtëzuar dhe e pa transferueshme.
 - (g) Garancia Bankare mund të përfshijë nënshkrimin(et) alternativ/e me shkrim dore ose nënshkrimin (et) e kualifikuar/a elektronik/e (QES) nga Banka emetuese. Në rast se Garancia Bankare nënshkruhet me nënshkrim të kualifikuar elektronik (QES), të gjitha ndryshimet e mëposhtme do të nënshkruhen me nënshkrim të kualifikuar elektronik (QES);
 - (h) Banka që lëshon Garancinë Bankare do të përcaktohet në mënyrë të përhershme, përfshirë përmes një dege në një shtet anëtar të BE-së, Zonës Ekonomike Evropiane, Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, Shtet Vëzhgues i Komunitetit të Energjisë, ose Zvicër dhe duhet të jetë e pranueshme nga banka e biznesit të Platformës së Alokimit.
 - (i) Banka që lëshon garancinë bankare ose grupi financiar që i përket, do të ketë një normë afatgjatë të kredisë jo më pak se BBB- nga Korporata Standard dhe Poor, BBB- nga Fitch ose Baa3 nga investitorët Moody Service Inc. Nëse banka lëshuese ose grupi financiar që i lëshon banka, nuk e ka normën e kërkuar afatgjatë të kreditit, pjesëmarrësi i regjistruar brenda pesë (5) ditëve të punës do të dorëzojë në Platformën e Alokimit një garanci zëvendësuese të bankës nga një bankë në përputhje me vlerësimin e kërkuar afatgjatë të kredisë ose të zëvendësoj garancin bankare me depozit. Nëse ka rënie në industrinë e institucioneve financiare, Platforma e Alokimit mund të hetojë se cilat janë standardet e reja dhe, sipas gjykimit të saj nëse është e nevojshme, zvogëlon vlerësimin e kërkuar për një periudhë të kufizuar kohore, duke informuar Operatorët e Sistemit të Transmisionit dhe duke u kërkuar atyre për të informuar Autoritetet Rregullatore Kombëtare.
 - (j) Banka që lëshon Garancinë Bankare nuk duhet të jetë filial e Pjesëmarrësit të

Regjistruar për të cilin është lëshuar Garancia Bankare.

2. Garancia Bankare duhet të përmbajë:
 - (a) Shumën maksimale të garantuar;
 - (b) Identifikimin e Platformës së Alokimit si përfituese, sic është përcaktuar në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;
 - (c) Llogaria Bankare e Platformës së Alokimit, sic është përcaktuar në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;
 - (d) Adresa e bankës së Platformës së Alokimit, në faqen e internetit të Platformës së Alokimit;
 - (e) Identifikimi i plotë i Pjesëmarrësëve të Regjistruara, duke përfshirë emrin, adresën, regjistrin tregtar/komercial;
 - (f) Identifikimin e plotë e bankës sigurues; dhe
 - (g) Kohën e vlefshmëris
3. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të dorëzojë Garancin Bankare të paktën katër (4) ditë pune përpara mbylljes së periudhës së ofertave të ankandit, për të cilin do të përdoret si garanci ose përndryshe do të meret në konsiderat për ankandet e mëvonshme.
4. Platforma e Alokimit do të pranojë Garancinë Bankare të ofruar nga një Pjesëmarrës i Regjistruar nëse Garancia e Bankës ofrohet në përputhje me specifikimet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij Neni dhe në rast se Garancia Bankare përfshin nënshkrimin(et) me shkrim dore, origjinali i Garancisë Bankare është pranuar nga Platforma e Alokimit.
5. Platforma e alokimit do të konfirmojë pranimin e garancisë bankare ose do t'i dërgojë njoftimin për refuzim pjesëmarrësit të regjistruar jo më vonë se 4 (katër) ditë pune pas pranimit të origjinalit të garancisë bankare. Deklarata e konfirmimit ose e refuzimit do të dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Njoftimi i refuzimit duhet të jetë i arsyetuar.

Neni 20

Vlefshmëria dhe rinovimi i Garancisë Bankare

1. Kolaterale të formës së Garancisë Bankare do të jenë të vlefshme për një periudhë minimale deri në tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të muajit kalendarik të Periudhës së Produktit.
2. Gjatë kësaj periudhe, pjesëmarrësi i regjistruar do të mbajë në çdo kohë kolaterale të formës së një Garancie Bankare, e cila përfshin detyrimin e Pjesëmarrësit të Regjistruar për të zëvendësuar ose rinovuar ato sipas kërkesës.

Neni 21

Limiti i Kreditit

1. Platforma e alokimit do të llogarisë dhe përditësojë vazhdimisht Limitin e Kreditit të secilit pjesëmarrës të regjistruar në lidhje me çdo ankand të mëvonshëm. Limiti i kredisë do të jetë i barabartë me shumën e kolateraleve minus çdo detyrim pagese të papaguar. Në rast të një Garancie Bankare, Garancia e Bankës do të konsideroh vetëm nëse plotësohen kërkesat e Nenit 20 në lidhje me vlefshmërinë e saj për Ankandin përkatës. Platforma e Alokimit do të paraqes këte informacion në mënyrë individual te secili pjesëmarrës i regjistruar nëpërmjet programit të alokimit.
2. Detyrimet e pagesave të papaguara llogariten sipas Nenit 47, subjekt i rregullave shtesë në paragrafët 3 deri 4 të këtij neni dhe në Nenin 32.
3. Për llogaritjen e limitit të kredisë, detyrimet e papaguara të pagesave do të rriten për të përfshirë taksat dhe tatimet në fuqi, në përputhje me nenin 48.
4. Detyrimet maksimale të pagesës për një pjesëmarrës të regjistruar që rezulton nga ofertat e tij të regjistruara në mbylljen e periudhës së ofertimit, të llogaritur sipas nenit 32, do të konsiderohen përkohësisht si detyrime të papaguara të pagesës. Nga publikimi i rezultateve të Ankandit, shumat e duhur e njoftuar sipas Nenit 34 paragrafi 3 (b) dhe (c) do të konsiderohet si detyrim i pagesave të papaguara për llogaritjen e Limitit të Kredisë për çdo Ankand dhe Kufiri i Kreditit do të rishikohet në bazë të alokimit aktual të Drejtave të Transmetimit Ditor.

Neni 22

Modifikime të Kolateralëve

1. Një Pjesëmarrës i Regjistruar mund të kërkojë në formë të shkruar një rritje të kolateraleve në formë të Garancisë Bankare, ulje të kolateralit në formë të Garancisë Bankare dhe / ose depozita në para ose ndryshimin e formës së kolateralit në çdo kohë në përputhje me Paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.
2. Ulja e kolateralit të Pjesëmarrësit të Regjistruar do të pranohet vetëm nëse kufiri i kreditit pas aplikimit të kërkesës për uljen e kolateralit do të ishte më e madhe ose baraz me zero.
3. Platforma e Alokimit do të pranojë modifikimin e kolateraleve nëse kërkesa për modifikim të kolateraleve është në përputhje me kushtin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni në rast rënije ose me kushtet e përcaktuara në nenet 19 dhe 20 në rastin e një rritje të kolateraleve në formën e një Garancie Bankare dhe në rast të një ndryshimi në formën e kolateralit nga një depozitë në para në Garancionin Bankare.
4. Modifikimi i kolateralit do të bëhet i vlefshëm dhe efektiv vetëm kur të jenë bërë modifikime të kolateralit të pjesëmarrësit të regjistruar në Platformën e Alokimit.

5. Platforma e Alokimit do të vlerësojë kërkesën për modifikimin e kolateraleve dhe të konfirmojë pranimin ose të njoftoj për refuzimin, pjesëmarrësit të regjistruar, të paktën dy (2) ditë pune pas pranimin të kërkesës. Deklarata e konfirmimit ose e refuzimit do të dërgohet nëpërmjet mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Njoftimi i refuzimit duhet të përfshijë arsyetimin për refuzim.

Neni 23

Incident kolaterali

1. Incidentet e kolateralit ndodhin në rastet e mëposhtme:
 - (a) Kolateralet janë të pamjaftueshme për të siguruar shumën e duhur për të Drejtat e Transmetimit Ditor mbajtura nga një Pjesëmarrës i Regjistruar në datën e ardhshme të pagesës siç përcaktohet në Nenin 49 duke marrë parasysh sasinë dhe vlefshmërinë e kolateralit. Ose
 - (b) Kolateralet nuk përdoren në përputhje me nenin 20 paragrafi 2.
 - (c) Kolaterali nuk risillet në përputhje me Nenin 24 pas një incidenti në pagesë ose kolaterali i ri i siguruar nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në Nenet 17 (3), 18 dhe 19.
2. Platforma e Alokimit do të njoftojë mbi incidentet e kolateraleve Pjesëmarrësit e Regjistruar me anë të mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të rrisë kolateralin e tij brenda dy (2) Ditëve të Punës nga dërgimi i njoftimit nëse ky njoftim është bërë gjatë orarit të punës ose dy (2) Ditëve të Punës duke filluar nga Dita e ardhshme e Punës nëse është dërguar pas orarit të punës. Nëse kolateralet e ofruara nga Pjesëmarrësi i Regjistruar mbeten të pamjaftueshme pas kësaj periudhe, Platforma e Alokimit mund të pezullojë ose përfundojë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në përputhje me nenet 55 dhe 56.

Neni 24

Kërkesë për kolateral

1. Platforma e Alokimit ka të drejtë të kërkojë kolateral nga një Pjesëmarrës i Regjistruar në rast të incidenteve të pagesave në përputhje me Nenin 51.
2. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të rivendosë kolateralin e tij pas një incidenti pagese ose kolaterale duke ndjekur kushtet e parashikuara në nenet 17 (3), 18 dhe 19, përveç nëse Marrëveshja e Pjesëmarrjes pezullohet ose ndërpritet në përputhje me nenet 55 dhe 56.

Kapitulli 4

Ankandi

Neni 25

Dispozitat e përgjithshme për Ankandet

1. Platforma Alokimit do të alokojë të Drejtat e Transmetimit Ditor për Pjesëmarrësit e Regjistruar nëpërmjet Alokimit Explicit. Para Ankandit, Platforma e Alokimit duhet të publikojë Specifikimet e Ankandit në faqen e saj të internetit.
2. Ankandet do të organizohen përmes Programit të Ankandit. Çdo Pjesëmarrës i Regjistruar që përmbush kërkesat për pjesëmarrjen në ankand mund të vendosë oferta në Programin e Ankandit deri në afatin e duhur kohor të përcaktuar sipas Specifikave Përkatese të ankandit.
3. Pas mbarimit të afatit kohor të përshtatshëm për vendosjen e ofertave, Platforma e Alokimit do të vlerësojë ofertat duke përfshirë përkatesisht kufirin e kredis të Pjesëmarrësve të Regjistruar. Pjesëmarrësit e Regjistruar do të informohen rreth rezultateve të ankandit nëpërmjet Programit të Ankandit.

Neni 26

Kohëzgjatja e Alokimit të Kapacitetit dhe forma e produktit

1. Kohëzgjatja e Alokimit të kapaciteteve është subjekt i Rregullave të Alokimit, dhe në varësi të disponueshmërisë së produktit është afati ditor i cili përbëhet nga çdo orë përgjatë 24 orëve të një dite kalendarike (23 ose 25 orë kur ora ditore ndryshon). Alokimi i të Drejtave të Transmetimit Fizik kryhet vecmas për secilën orë të Periudhës së Produktit, prandaj mund të ofrohet sasi të ndryshme MË në orë, oferta të ndara dhe mund të alokohen sasi të ndryshme në MË.
2. Ankandi ditor do të mbahet çdo ditë në ditën para ditës së dorëzimit (e Hënë - e Diel).

Neni 27

Specifikimet e Ankandit

1. Platforma e Alokimit do të publikojë Specifikimet e Ankandit, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, jo më vonë se ora 09:00 e ditës para ditës së dorëzimit.
2. Specifikimi i Ankandit duhet të theksojë në veçanti:
 - (a) Kodin identifikues të ankandit në programin e ankandit

- (b) Identifikimi i kufirit të zonës së ofertimit
- (c) Periudha e Produktit
- (d) Në kushtet e operimit normal periudha e ofertimit fillon në orën 09:00 a.m dhe mbaron në orën 09:30 të ditës para ditës së dorëzimit
- (e) Në kushtet e operimit normal afati i fundit për publikimin e rezultateve të përkohshme të ankandit është 09:30 a.m një ditë para ditës së dorëzimit;
- (f) Në kushte e operimit normal afati i fundit për publikimin e rezultateve përfundimtare të ankandit është në 10:00 a.m një ditë para ditës së dorëzimit;
- (g) Kapaciteti i ofruar do të përfshijë Kapacitetin Ndërkufitar të realizuar në përputhje me nenet 55 dhe 56; dhe
- (h) Çdo informacion tjetër ose terme të aplikueshëm për produktin ose ankandin.

Neni 28

Paraqitja e ofertave

1. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të paraqesë një ofertë ose disa oferta në Platformën e Alokimit në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
 - (a) Oferta do të paraqitet në mënyre elektronike duke përdorur Programin e Ankandit gjatë periudhës së ofertave sic është shprehur në Specifikimet e Ankandit.
 - (b) Ankandi do të identifikohet nga një kod identifikimi sic është specifikuar në nënin 27 paragrafi 2(a)
 - (c) Pjesëmarrësi i Regjistruar që paraqet ofertën do të identifikohet përmes kodit EIC;
 - (d) Identifikimi i zonës së ofertimit kufiri dhe drejtimi për të cilën është paraqitur oferta
 - (e) Do të përcaktoj cmimin e ofertës, e cila do të jetë e ndryshme për çdo ofertë të njëjtë Pjesëmarrës të Regjistruar, pa taksa dhe tatime, në Euro për MË për një orë të periudhës së produktit, dmth. Euro/MËh, me dy shifra dhjetore, dhe më e madhe ose e barabartë më zero.
 - (f) Vlera minimale e kapacitetit që kërkohet në një ofertë është një (1) MË. Kapaciteti i ofruar duhet të shpehet në numër të plotë.
2. Pjesëmarrësi i regjistruar mund të modifikojë ofertën e tij të regjistruar më parë ose ciftin e ofertës në çdo kohë gjatë periudhës së ofertimit duke përfshirë anulimin e saj. Për përcaktimin e rezultateve të ankandit do të meret parasysh vetëm modifikimi i fundit i vlefshëm i ofertës ose grupit të ofertave.
3. Nëse sasia e ofruar e kapacitetit të ofertës ose sasia e kapacitetit e llogaritur si shume për disa oferta të paraqitura në ankand gjatë periudhës së ofertimit nga Pjesëmarrësit e Regjistruar e tejkalon Kapacitetin e Ofruar që është shpalluar në Specifikimet e Ankandit, ky ofert ose këto ofertat do të refuzohen plotësisht. Kur modifikimi i ofertave të paraqitura më parë rezulton në tejkalimin e kapacitetit të ofruar, modifikimi do të refuzohet dhe ofertat e regjistruara më parë do të qëndrojnë.

Neni 29
Regjistrimi i Ofertës

1. Platforma e Alokimit nuk do të regjistrojë ofertat që:
 - (a) nuk përputhet me kërkesat e nenit 28 ose
 - (b) paraqitet nga një Pjesëmarrës i Regjistruar i cili është pezulluar në përputhje me nenin 55.
2. Nëse oferta ose çifti i ofertave përmbush kërkesat e përaktuara në nenet 28, nëpërmjet Programit të Ankandit, Platforma e Alokimit do t'i konfirmojë Pjesëmarrësit të Regjistruar se oferta të tilla janë regjistruar në mënyrë korrekte. Nëse Platforma e Alokimit nuk lëshon një vërtetim pranimit për ofertën, atëherë oferta e tillë do të konsiderohet se nuk është regjistruar.
3. Platforma e Alokimit do të njoftoj pjesëmarrësit e regjistruar nëse oferta është e pavlefshme dhe arsyeja për këtë refuzim, pa vonesa të panevojshme pasi oferta është refuzuar.
4. Platforma e Alokimit duhet të mbajë një regjistër të të gjitha ofertave të vlefshme të pranuar.
5. Cdo ofertë e vlefshme e regjistruar në mbylljen e periudhës së tenderit do të përbëjë një ofertë të pa kushtëzuar dhe të përvokushme nga Pjesëmarrësi i Regjistruar për të blerë të Drejtat e Transmetimit Ditor deri në sasinë e kapacitetit të ofertës dhe me çmime sa çmimi i ofertës sipas kushteve të Rregullave të Alokimit dhe Specifikimit përkatës të Ankandit.

Neni 30

Oferta të Paracaktuara

1. Pjesëmarrësit e Regjistruar kanë opsionin e vendosjes së ofertës të paracaktuar për Ankandin.
2. Një ofertë e paracaktuar, e identifikuar si e tillë nga Pjesëmarrësi i Regjistruar, do të aplikohet automatikisht në çdo ankand përkatës të mëvonshëm. Gjatë Periudhës së Ofertimit, oferta e paracaktuar e regjistruar konsiderohet si ofertë e paraqitur nga pjesëmarrësi i regjistruar për ankandin përkatës. Kjo oferte do të konsiderohet e dërguar kur Platforma e Alokimit njofton Pjesëmarrësin e Regjistruar për pranimin e ofertës.
3. Nëse sasia e ofruar e kapacitetit të ofertës ose sasia e kapacitetit të llogaritur si shume për disa oferta të paraqitura në të njëjtin ankand nga Pjesëmarrës i Regjistruar, tejkalon kapacitetin e ofertuar përfundimtar, ofertat me çmimin më të ulët të ofertës do të refuzohen një (1) nga një (1) derisa shuma totale e lejuar e ofertës është më e ulët ose e barabartë me kapacitetin e ofruar.
4. Një Pjesëmarrës i Regjistruar që dëshiron të modifikojë një ofertë të paracaktuar për një ankand të ardhshëm duhet të ndryshojë sasinë dhe çmimin e ofertës përpara hapjes së periudhës së ankandit.
5. Një Pjesëmarrës i Regjistruar që nuk dëshiron të paraqes ofertën e paracaktuar në Programin e Ankandit për ankandet e ardhshme mund të anulojë ofertat e tij të paracaktuar përpara hapjes së periudhës së ankandit pasues.

Neni 31

Proceduar e sigurisë për Ofertat e Paracaktuara

Në rastin e mos disponibilitetit të Platformës së Ankandit do të ndiqet procedura e sigurisë në përputhje me Neni 42. Oferta e paracaktuar e paraqitur në orën 14:00h D-2 (dy (2) ditë kalendarike para ditës D) do të përdoren si oferta të paracaktuara për procedurën e sigurisë.

Neni 32

Verifikimi i limitit të kredisë

1. Me paraqitjen e ofertës ose grupit të ofertave në programin e Ankandit të Pjesëmarrësve të Regjistruar, Platforma e Ankandit do të kontrollojë nëse detyrimi maksimal i pagesës (MPO) lidhur me ofertat e regjistruara llogaritur sipas paragrafëve 4 dhe 5 të këtij neni në kohën e dorëzimit të ofertave tejkalon kufirin e kredisë. Nëse detyrimi maksimal i pagesës lidhur me ofertat e regjistruara tejkalon limitin e kredisë, Platforma e Alokimit do të lëshojë automatikisht nëpërmjet Programit të Ankandit një paralajmërim për Pjesëmarrësit e Regjistruar për të modifikuar limitin e kredisë. Ofertat nuk do të refuzohen automatikisht nëse detyrimi maksimal i pagesës që i atribuohet ofertës së

regjistruar tejkalon limitin e kredisë, por vetëm pas procesit të përshkruar në paragrafin 2 të këtij neni.

2. Me mbylljen e Periudhës së Ofertimit, Platforma e Alokimit do të kontrollojë përsëri nëse detyrimet maksimale të pagesës lidhur me ofertat e regjistruara të llogaritura sipas paragrafit 5 të këtij neni, tejkalojnë Kufirin e Kreditit. Nëse detyrimet maksimale të pagesës lidhur me këto oferta tejkalojnë kufirin e kredisë, këto oferta, duke filluar me ofertën me çmimin më të ulët, do të jenë të përjashtuara një (1) nga një (1), derisa detyrimet maksimale të pagesës të jenë më të vogla ose të barabarta në Kufirin e Kreditit.
3. Gjatë njoftimitimit të rezultateve të ankandit Platforma e Alokimit do të paraqes pamjaftueshmerin kolaterale si arsye për përjashtimin e ofertës, Pjesmarrësvë të Regjistruar.
4. Platforma e Alokimit do të vlerësojë në mënyrë të vazhdueshme të gjitha ofertat në mënyrë të pavarur të secilit Ankand, në lidhje me kufirin dhe drejtimin për të cilën është kërkuar kapacitet. Në rast se ofertat janë të lidhura me ankande të ndryshme dhe janë të mbivendosura, Platforma e Alokimit do të marrë parasysh të gjitha detyrimet maksimale të llogaritura të pagesave si pagesa të papaguar sipas nenit 21.
5. Për llogaritjen e detyrimeve maksimale të pagesave që kanë të bëjnë me një Zonë Ofertuese kufi dhe drejtim, Platforma e Alokimit do të rendisë ofertat e Regjistruara të një Pjesëmarrësi të Regjistruar sipas Çmimit të Ofertës në rend zbritës (merit-order). Oferta një (1) do të jetë oferta me çmimin më të lartë dhe oferta n do të jetë oferta me çmimin më të ulët. Platforma e alokimit do të llogarisë detyrimet maksimale të pagesave sipas ekuacionit të mëposhtëm:

$$MMMMM = \sum [C_{mimi\ i\ ofertës\ (1)} * Sasia\ e\ kapacitetit\ (1); C_{mimi\ i\ ofertës\ (2)} * \sum Sasia\ e\ kapacitetit\ (ii); \dots 2ii=1\ orë\ \dots; C_{mimi\ i\ ofertës\ (nn-1)} * Sasia\ e\ kapacitetit\ nn-1\ ii=1; C_{mimi\ i\ ofertës\ (nn)} * \sum Sasia\ e\ kapacitetit\ (ii)nnnn=1]$$

6. Gjatë llogaritjes së detyrimeve maksimale të pagesave sipas paragrafit 5 të këtij neni, Platforma e Alokimit do të marrë gjithashtu parasysh taksat dhe tatimet në fuqi sipas të nenit 48.

Njoftimi i rezultateve të ankandit

1. Pas përfundimit të Periudhës së Ofertimit për një ankand dhe verifikimin e Kufirit të Kreditit në përputhje me nenin 32, Platforma e Alokimit do të njoftojë rezultatet e Ankandit dhe do të alokojë të Drejtat e Transmetimit Ditor në përputhje me këtë Nen.
2. Njoftimi i rezultateve të ankandit do të përfshijë:
 - (a) Sasinë totale të alokuar të të Drejtave të Transmetimit Ditore të zonës së ofertuar kufi dhe drejtim.
 - (b) Identifikimi i ofertave fituese, të pranuar plotësisht ose pjesërisht; dhe
 - (c) Çmimi Marxhinal i Ankandit në €/MËh për zonën e ofertimit.
3. Platforma e Alokimit do të përcaktojë rezultatet e Ankandit duke përdorur një funksion optimizimi me qëllim të maksimizimit të shumës të Pjesëmarrësve të Regjistruar dhe të ardhurave të gjeneruara nga ofertat fituese, duke respektuar kufizimet e funksionit të optimizimit në formën e Kapaciteteve të Ofruara. Platforma e alokimit do të publikojë informacione shpjeguese shpesh mbi funksionin e optimizimit të algoritmit në faqen e saj të internetit.
4. Platforma e alokimit do të përcaktojë çmimin marxhinal në çdo zonë ofertimi kufi /drejtim bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - (a) Nëse sasia totale e kapacitetit ndërkufitar për të cilën janë paraqitur oferta të vlefshme është më e ulët ose e barabartë me kapacitetin e ofruar për ankandin përkatës, atëherë çmimi marxhinal do të jetë zero;
 - (b) Nëse sasia totale e kapacitetit ndërkufitar për të cilën janë paraqitur oferta të vlefshme tejkalon kapacitetin e ofruar për ankandin përkatës, çmimi marxhinal vendoset me çmimin më të ulët të ofertave të alokuara plotësisht ose pjesërisht.
5. Nëse dy (2) ose më shumë Pjesëmarrës të Regjistruar kanë paraqitur ofertën për kufi dhe drejtim me çmim të njëjtë, dhe kjo ofertë nuk mund të pranohet e plotë për sasinë totale të kapacitetit të kërkuar të Drejtave të Transmetimit Ditor, Platforma e Alokimit do të përcaktojë ofertën fituese dhe sasinë e kapacitetit të alokuar për Pjesëmarrësin e Regjistruar si më poshtë:
 - (a) Kapaciteti Ndërkufitar i disponueshëm do të ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet numrit të Pjesëmarrësve të Regjistruar që paraqitën këto oferta.
 - (b) Në rast se sasia e të Drejtave të Transmetimit Ditor i kërkuar nga një Pjesëmarrës i Regjistruar është më e ulët ose e barabartë se vlera e llogaritur sipas pikës (a) më lart, kërkesa e këtij Pjesëmarrësi të Regjistruar do të plotësohet.
 - (c) Në rast se sasia e kërkuar e të Drejtave Ditore të Transmetimit nga një Pjesëmarrës i Regjistruar tejkalon vlerën e llogaritur sipas pikës (a) më sipër, kërkesa e këtij Pjesëmarrësi të Regjistruar duhet të plotësohet deri në shumën e vlerës të llogaritur sipas pikës (a) më sipër;

- (d) Çdo kapacitet tjetër ndërkufitar pas alokimit sipas pikave (b) dhe (c) do të ndahet me numrin e Pjesëmarrësve të Regjistruar kërkesat e të cilave nuk janë plotësuar plotësisht dhe u është alokuar duke zbatuar procesin e përshkruar në pikat (a), (B) dhe (c) më lart.
 - (e) Çdo kapacitet ndërkufitar i mbetur pas alokimit sipas pikës (d), do të ndahet duke përdorur kriteret e kronologjike (time-stamp).
6. Kur llogaritja e përcaktuar në paragrafët 3 deri 5 të këtij neni nuk rezulton me një numër të plotë MW në përputhje me Nenin 28 paragrafi 1 (f), Të Drejtat Ditore të Transmetimit do të rumbullakosen në vlerën më të afërt të plotë. Në rastin kur të Drejtat Ditore të Transmetimit të cilat i janë alokuar Pjesëmarrësve të Regjistruar individual, janë të barabarta me zero edhe pas rumbullakimit, atëhere ato nuk do të ndikojnë në përcaktimin e Çmimit Marxhinal.
7. Të Drejtat Ditore të Transmetimit konsiderohen se i janë alokuar Pjesëmarrësve të Regjistruar, që nga momenti kur pjesëmarrësi i Regjistruar është informuar mbi rezultatet. Në rast se Ankandi nuk është zhvilluar me sukses, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në Kapitullin 6.

Neni 34

Njoftimi i rezultateve të Ankandit

1. Platforma e Alokimit të kapacitetit, do të bëjë të disponueshme rezultatet e Ankandit të përkohshëm në Platformën e Ankandit, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se ora 9:40 a.m.
2. Publikimi i rezultateve të Ankandit për çdo kufi të Zonës së Ofertës dhe për çdo orë të ditës së përfshirë në Ankand, duhet të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:
 - a) Totalin e kërkuar të të Drejtave Ditore të Transmetimit, në MË;
 - b) Totalin e Alokuar të të Drejtave Ditore të Transmetimit, në MË;
 - c) Çmimin marxhinal në Euro / MË orë;
 - d) Numrin e pjesëmarrësve të Regjistruar që marrin pjesë në Ankand;
 - e) Listën e emrave dhe numrin e pjesëmarrësve të Regjistruar që kanë vendosur së paku një ofertë fituese në Ankand;
 - f) Listën e ofertave të Regjistruara pa identifikimin e pjesëmarrësve të Regjistruar (kurba e ofertës); dhe
 - g) Të ardhurat nga Kongestionet për Zonat e Ofertave.

3. Jo më vonë se 30 minuta pas publikimit të rezultateve të Ankandit, Platforma e Alokimit, nëpërmjet programit të dedikuar, do të vërë në dispozicion të Pjesëmarrësve të Regjistruar të cilët kanë dorëzuar një ofertë në një Ankand të caktuar për çdo kufi të Zonës së Ofertës, të dhënat e mëposhtme:
 - a) Të Drejtat Ditore të Transmetimit për çdo orë të Periudhës së Produktit, në MË;
 - b) Çmimi marxhinal në Euro / MW orë; dhe
 - c) Shumën e detyrimit për tu paguar, për alokimin e të Drejtave Ditore të Transmetimit, në Euro (€), të rrumbullakosura me dy shifra pas presjes dhjetore; dhe
 - d) Dokumenti CAI i cili atribuon të Drejtat Ditore të Transmetimit.
4. Në rast se programi i dedikuar i Ankandit është i padisponueshëm, Platforma e Alokimit të Kapacitetit, do të informojë Pjesëmarrësit e Regjistruar mbi Rezultatet e Ankandit në përputhje me Kapitullin 6.
5. Pjesëmarrësit e Regjistruar do të kontrollojnë rezultatet e Ankandit dhe, kur vlerësohet si e përshtatshme, mund të kundërshtojnë rezultatet e Ankandit brenda periudhës së kontestimit të përcaktuar në paragrafin 6 të këtij Neni. Platforma e alokimit do të shqyrtojë vetëm një kontestim ku Pjesëmarrësi i Regjistruar është në gjendje të demonstrojë një gabim nga Platforma e Alokimit në rezultatet e Ankandit.
6. Pjesëmarrësi i Regjistruar mund të kontestojë rezultatet e Ankandit brenda afatit të përcaktuar në Specifikimet përkatëse të Ankandit.
7. Kontestimi do të njoftohet në Platformën e Alokimit dhe do të identifikohet nëpërmjet një njoftimi bashkangjitur me statusin "kontestim".
8. Çdo kontestim duhet të përmbajë informacionet e mëposhtme:
 - (a) Data e kontestimit;
 - (b) Identifikimin e Ankandit të kontestuar;
 - (c) Identifikimin e pjesëmarrësit të Regjistruar;
 - (d) Emrin, adresën e e-mailit dhe numrin e telefonit të pjesëmarrësit të Regjistruar;
 - (e) Përshkrimin e hollësishëm të fakteve dhe arsyet e kontestimit; dhe
 - (f) Evidencat e rezultateve të gabuara të Ankandit;
9. Platforma e Alokimit do të njoftojë pjesëmarrësit e Regjistruar mbi vendimin e marrë lidhur me kontestimet e tyre jo më vonë se një (1) orë pasi rezultatet e Ankandit të përkohshëm i janë njoftuar Pjesëmarrësit të Regjistruar.
10. Në rast se asnjë kontestim nuk është paraqitur brenda afatit të përcaktuar në Specifikimet përkatëse të Ankandit, rezultatet e përkohshme të Ankandit do të publikohen dhe do të konsiderohen si përfundimtare, si dhe do të jenë në dispozicion në faqen e internetit të Platformës së Ankandit.

KAPITULLI 5

Përdorimi i të Drejtave Ditore të Transmetimit

Neni 35

Parime të përgjithshme

1. Të Drejtat fizike të Transmetimit, të alokuara nëpërmjet Ankandit do të jenë subjekt i parimit “Përdore ose Humbe”.
2. Fituesi i Ankandit të alokimit mbi të Drejtat fizike të Transmetimit, mund të nominojë përdorimin fizik të kapacitetit të tij, mbi bazën e të Drejtave të Transmetimit Fizik të fituar, në përputhje me Nenin 36.
3. Në rast se fituesi i të Drejtave të Transmetimit Ditor të kapacitetit, i rezervon të Drejtat e Transmetimit Fizik të tij për shërbimet balancuese, psh për shërbimin e balancimit ndër kufitar, atëherë ai do të përjashtohet nga zbatimi i parimit “Përdore ose Humbe”.

Neni 36

Nominimi i të Drejtave të Transmetimit Fizik

1. Personat të cilët kanë të drejtë të nominojnë mbi të Drejtat e Transmetimit Fizik, duhet të përmbushin kërkesat e përshkruara në Rregullat e Nominimit në fuqi. Personat e kualifikuar mund të jenë:
 - (a) Fituesi i të Drejtave të Transmetimit Fizik;
 - (b) Personi i njoftuar nga fituesi i të Drejtave të Transmetimit Fizik gjatë procesit të nominimit, tek Operatorët përkatës të Sistemit të Transmetimit në përputhje me Rregullat përkatëse të Nominimit.
 - (c) Personi i autorizuar nga Mbajtësi i të Drejtave Fizike të Transmetimit për të nominuar në përputhje me Rregullat e Nominimit dhe i njoftuar në Platformën e Alokimit
2. Platforma e Alokimit të kapacitetit do të mundësojë në faqen e saj të internetit një pasqyrim të opsioneve të renditura në paragrafin 1 të këtij Neni, të cilat janë të zbatueshme në çdo kufi të Zonës së Ofertës.
3. Procesi i nominimit duhet realizuar në përputhje me Dokumentin e të Drejtave të Transmetimit.
4. Platforma e alokimit do të publikojë një listë me rregullat relevante të nominimit për kufijtë e zonës së ofertës, në faqen e saj të internetit.

5. Afatet e nominimit për kufijtë e zonave përkatëse të ofertave janë të përcaktuara në Rregullat përkatëse të Nominimit. Platforma e alokimit do të publikojë këto informacione në faqen e saj të internetit për afatet e nominimit për cdo kufi të zonës së ofertave. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis afateve të publikuara nga Platforma e Alokimit dhe afateve të rregullave relevante dhe të detyrueshme ligjore, ky i fundit do të prevalojë dhe Platforma e Alokimit nuk do të jetë përgjegjëse për çdo dëmtim të shkaktuar nga një mospërputhje e tillë.

Neni 37

Dokumenti i Drejtave të Kapacitetit

1. Dokumenti i të Drejtave të Kapacitetit përmban informacionin mbi volumin në MË që personat e kualifikuar kanë të drejtë të nominojnë në secilën zonë oferte në cdo kufi, si dhe drejtimin për cdo periudhë kohore në rezolucionin orar.
2. Platforma e Alokimit duhet të dërgojë Dokumentin e Drejtave të Kapacitetit çdo ditë dhe jo më vonë se tridhjetë (30) minuta pasi rezultatet e Ankandit t'i jenë njoftuar personit të kualifikuar të Pjesëmarrësve të Regjistruar bazuar në Nenin 36 të paragrafi 1 (a).

Neni 38

Rezervimi i të Drejtave të Transmetimit Fizik për shërbimet balancuese

Në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, mund të kërkohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit të ofrohet shërbimi balancuese, rast në të cilin mund të njoftojë Platformën e Alokimit mbi rregullat e tij të balancimit. Nëse ky shërbim ofrohet, për aq sa Operatori i Sistemit të Transmetimit do të ofrojë në shërbimin balancues, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, rregullat e balancimit do të bëhen dhe pjesë e Rregullave të Alokimit, të zbatueshme në kufirin e zonës përkatëse të ofertave.

KAPITULLI 6

Procedurat e tërheqjes nga Ankandi ose anulimit

Dispozita të përgjithshme

1. Platforma e alokimit, në një masë që është praktikisht e arsyeshme, organizon një procedurë rezervë në rast të dështimit të një procesi standard si më poshtë:
 - (a) nëse është teknikisht e pamundur të realizohet një Ankand, për shembull në rastet e mëposhtme:

Nëse nuk është teknikisht e mundur të përdoret procedura standarde e shkëmbimit të të dhënave; ose

Në rast se Platforma e Alokimit përballlet me pengesa teknike gjatë procesit të Ankandit; ose
 - (b) në rast të rezultateve të gabuara për shkak të llogaritjes së gabuar të cmimit Marxhinal; ose
 - (c) në rast të alokimit jo korrekt të së drejtës së Transmetimit Ditor të kapacitetit për Pjesëmarrësit e Regjistruar, ose për arsye të ngjashme me to.
2. Platforma e Alokimit mund të përdorë një ose të gjitha procedurat vijuese të mëposhtme rezervë:
 - (a) paraqitja e një procedure rezervë për shkëmbimin e të dhënave sipas Nenit 40;
 - (b) Shtyrja e fillimit të Periudhës së Tenderit të Ankandit në një kohë të mëvonshme, por jo më vonë se 10:30 a.m .
 - (c) futjen në përdorim të e një Ankandi rezervë sipas Nenit 42.
 - (d) një tjetër procedurë ad hoc rezervë në rast se konsiderohet si e përshtatshme nga Platforma e Alokimit me qëllimin për të kapërcyer pengesat teknike.
3. Platforma e Alokimit të kapacitetit , në masën që konsiderohet si e mundur dhe pa vonesa të panevojshme, infromon Pjesëmarrësit e Regjistruar për devijimet e mundshme nga proceset standarde dhe aplikimin e një procedure rezervë përmes mjeteve elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit si dhe duke përdorur programin e dedikuar të Ankandit.
4. Pjesëmarrësit e Regjistruar duhet të informojnë menjëherë Platformën e Alokimit për çdo problem të vërejtur në lidhje me përdorimin e programit të Ankandit së bashku me të gjitha pasojat e mundshme që mund të hasen, nëpërmjet mjeteve elektronike, siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Në rast të përballjes me ndonjë problem urgjent, i cili duhet të zgjidhet menjëherë dhe i cili identifikohet gjatë Orëve të Punës, Pjesëmarrësi i Regjistruar duhet që menjëherë të kontaktojë Platformën e Alokimit me telefon në numrin e telefonit të treguar në faqen e internetit të Platformës së Alokimit për këtë lloj problemi. Platforma e alokimit do të konfirmojë pranimin e problemit dhe do të informojë pjesëmarrësit e Regjistruar për statusin e problemit sa më shpejt që të jetë e mundur.

Procedura rezervë për shkëmbimin e të dhënave

1. Në rast të një dështimi të proceseve standarde për shkëmbimin e të dhënave përmes Programit të Ankandit të Platformës së Alokimit, sic përshkruhet në këto Rregulla të Alokimit, Platforma e Alokimit mund të informojë Pjesëmarrësit e Regjistruar se mund të përdoret një procedurë rezervë për shkëmbimin e të dhënave si në vazhdim:
 - (a) sipas afateve të të aplikueshme dhe të mirëpërcaktuara, nëse nuk shprehet ndryshe nga Platforma e Alokimit, Pjesëmarrësi i Regjistruar do të kërkojë përmes mjeteve elektronike, siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit, që të fusë të dhënat përkatëse në programin e Ankandit, duke përdorur këtë procedurë rezervë për shkëmbimin e të dhënave;
 - (b) me kërkesë të pjesëmarrësve të Regjistruar, do të mundësohet në Platformën e Alokimit në formatin e specifikuar në Sistemin e Rregullave të Informacionit, të dhënat përkatëse që do të futen në softin e Ankandit;
 - (c) Platforma e Alokimit duhet të futë të dhënat e dorëzuara në soft-in e Ankandit;
 - (d) Platforma e Alokimit mund të ofrojë vendosej e një procesi shtesë në Sistemin e Rregullave të Informacionit. Proces i cili do të bëjë të mundur identifikimin e Pjesëmarrësit të Regjistruar, në momentin kur Pjesëmarrësi i Regjistruar paraqet të dhënat operative ose komerciale përkatëse dhe kërkon që Platforma e Alokimit të futë këto të dhëna në Soft-in e Ankandit në emër të tij, nëpërmjet procedurës rezervë. Nëse pjesëmarrësi i Regjistruar ose personi i autorizuar nga pjesëmarrësi i Regjistruar, nuk e identifikon qartë vetveten, Platforma e alokimit do të ketë të drejtën të mos kryejë regjistrimin e të dhënave;
 - (e) Pjesëmarrësi i Regjistruar duhet t'i sigurojë Platformës së Alokimit një numër telefoni, i cili mund të përdoret në rast të një komunikimi të nevojshëm;
 - (f) Pasi Platforma e Alokimit të ketë futur të dhënat e ofruara në Soft-in e Ankandit në emër të Pjesëmarrësit të Regjistruar, Platforma e Alokimit do të informojë, pa vonesa, Pjesëmarrësin e Regjistruar me telefon dhe / ose përmes mjeteve elektronike, siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit; dhe
 - (g) Platforma e Alokimit në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjëse nëse nuk arrin të realizohet komunikimi me pjesëmarrësin e Regjistruar nëpërmjet mjeteve të mësipërme të komunikimit.
2. Në rast të aplikimit të procedurës rezervë për shkëmbimin e të dhënave, të gjitha informacionet e nevojshme të cilat janë vënë në dispozicion përmes Programit të Ankandit gjatë procedurave standard, mund të shpërndahen tek Pjesëmarrësit e Regjistruar përmes mjeteve elektronike, siç specifikohet nga Platforma e Alokimit ose kur është e përshtatshme mund edhe të publikohen në faqen e internetit të Platformës së Alokimit.

Neni 41

Procedura rezervë për zhvillimin e Ankandit

1. Shtyrja e Ankandit do të jetë procedura standarde rezervë për Ankandet e kapacitetit para hapjes së Periudhës së Ofertimit. Platforma e alokimit mund të shtyjë një Ankand duke njoftuar pjesëmarrësit e Regjistruar për kohën e rishikuar të Ankandit të ri.
2. Pas hapjes së Periudhës së Tenderimit, Platforma e Alokimit do të:
 - (a) Aty ku është praktikisht e mundur, të shtyjë përfundimin e Periudhës së Tenderit, duke njoftuar Pjesëmarrësit e Regjistruar për afatet e rishikuara në Specifikimet e Ankandit; ose
 - (b) Të anulojë Ankandin fillestar sipas Nenit 43; dhe të organizojë një Ankand të ri mbi të njëjtin Produkt dhe për të njëjtën periudhë; ose
 - (c) Të aplikojë Ankandin sipas procedurës rezervë sic është specifikuar në Nenin 42.
3. Nëse procedura rezervë e përshkruar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij Neni nuk mund të jetë zbatohet për të njëjtin Produkt dhe periudhë kohore, atëherë kapacitetet ndërzonale përkatëse do të ofrohen në procesin e ardhshëm të Alokimit të Kapaciteteve.
4. Platforma e Alokimit do të informojë të gjithë Pjesëmarrësit e Regjistruar, pa vonesa, për shtyrjen e procesit, nëpërmjet njoftimit të publikuar në softin e Ankandit dhe / ose në faqen e Platformës së Alokimit dhe / ose përmes mjeteve elektronike, siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit.

Neni 42

Ankand Rezervë

1. Nëse Platforma e Alokimit, pas publikimit të Specifikimeve të Ankandit, nuk është në gjendje të realizojë Proceset e Ankandit për shkak të arsyeve të përmendura në Nenin 39, paragrafi 1, atëherë Platforma e Alokimit do t'i dërgojë njoftimin të gjithë Pjesëmarrësve të Regjistruar për aplikimin e Ankandit Rezervë, sa më shpejt të jetë e mundur, jo më vonë se 10:15 në ditën para datës së lëvrimin.
2. Në rastin e aplikimit të Ankandit Rezervë vetëm ofertat e paracaktuara të Ankandit Rezervë, në përputhje me Nenin 31, do të merren në konsideratë në procesin e Ankandit ditor. Nëse sasia e ofertës së paracaktuara, ose sasia e llogaritur si një shumë e sasive të ofertave për disa oferta të paracaktuara të paraqitura për të njëjtin Ankand, nga pjesëmarrësi i Regjistruar, tejkalon kapacitetin e ofertuar përfundimtar, atëherë sasia e ofertës do të zvogëlohet për tu barzuar me kapacitetin e ofruar.

3. Kapaciteti i ofruar është i ndarë në mënyrë proporcionale ndërmjet Pjesëmarrësve të Regjistruar.
4. Çmimi marxhinal i të dëjtave Ditore të Transmetimit është 0 € / MËh. Vlera e të dëjtave të transmetimit ditor do të rrumbullakosen në një vlerë të plotë MË-eesh.
5. Pjesëmarrësit e Regjistruar do të informohen rreth rezultateve të Ankandit deri në orën 10:45 në D-1.

Neni 43

Anullimi i Ankandit

1. Në rast se Platforma e Alokimit të Kapacitetit anulon një Ankand, atëherë të gjitha ofertat e paraqitura së bashku me rezultatet e Ankandit përkatës do të konsiderohen si të pavlefshme.
2. Platforma e Alokimit do të informojë të gjithë Pjesëmarrësit e Regjistruar, pa krijuar vonesa, mbi anulimin e procedurave të Ankandit, nëpërmjet njoftimit të publikuar në Softin e Ankandit ose në faqen e internetit të Platformës së Alokimit, gjithashtu edhe me mjete elektronike, siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit.
3. Anullimi i Ankandit mund të shpallet në rastet e poshtëpërmendura:
 - (a) para publikimit të rezultateve të përkohshme të Ankandit, në rast se Platforma e Alokimit ballafaqohet me pengesa të karakterit teknik gjatë procesit të Ankandit, si dhe për shkak të ndonjë dështimi të mundshëm të proceseve standarde, ose për shah të procedurave rezervë, ose për arsye të ngjashme me këto; dhe
 - (b) pas publikimit të rezultateve të përkohshme të Ankandit, në rast të përfitimit të rezultateve jo korrekte për shkak të llogaritjes së gabuar të çmimit marxhinal, ose shpërndarjes së gabuar të të Drejtave Ditore të Transmetimit tek Pjesëmarrësit e Regjistruar, ose për arsye të ngjashme me këto.
4. Në rast të anulimit të Ankandit para publikimit të rezultateve përfundimtare të Ankandit, pjesëmarrësit e Regjistruar nuk do të paguhet asnjë kompensim.
5. Platforma e Alokimit do të publikojë në faqen e saj të internetit, pa vonesa, arsyet që çuan në Anullimin e Ankandit.
6. Dispozitat e Nenit 43 mund të zbatohen edhe për një Ankand Rezervë (në rast të gjenerimit të rezultateve të gabuara).

KAPITULLI 7

Kufizimi

Neni 44

Eventet dhe pasojat e shkaktuara si pasojë e kufizimit të të Drejtave Ditore të Transmetimit

1. Të Drejtat Ditore të Transmetimit mund të kufizohen vetëm në raste Forcash Madhore ose situata emergjente.
2. Kufizimi mund të aplikohet në të Drejtat e alokuara ditore të Transmetimit, duke përfshirë kështu , edhe nominimet fizike të realizuara mbi Drejtat e Transmetimit.
3. Secili Pjesëmarrës i Regjistruar i afektuar nga ky kufizim, do të humbasë të drejtën e tij për të nominuar mbi përdorimin fizik të të Drejtave të Transmetimit, në rast se ai e gëzon këtë të drejtë në momentin e kufizimit.
4. Për pasojë, në rast kufizimi, pjesëmarrësi i Regjistruar nuk gëzon të drejtën e rimbursimit ose kompensimit.

Neni 45

Procesi dhe njoftimi i kufizimit

Në të gjitha rastet kufizimi do të realizohet nga një ose më shumë Operatorë të Sistemit të Transmetimit, për kufirin e Zonës së Ofertimit, aty ku janë alokuar të Drejtat Ditore të Transmetimit.

KAPITULLI 8

Faturimi dhe pagesa

Neni 46

Parime të përgjithshme

1. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të paguajë detyrimet, të cilat do të përlogariten në përputhje me Nenin 47, për të gjitha të Drejtat Ditore të Transmetimit që i janë alokuar atij.

2. Pjesëmarrësi i Regjistruar gëzon të drejtën që kundrejt pagesës të përdorë Kapacitetin Ndër Zonal, i cili lidhet me të Drejtat Ditore të Transmetimit, siç përshkruhet në Rregullat e Alokimit. Çdo e drejtë për përdorimin fizik të sistemit të transmetimit mund të jetë subjekt i marrëveshjeve të diferencuara ndërmjet Pjesëmarrësit të Regjistruar dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit përkatës.
3. Të gjithë informacionet financiare, të cilat lidhen me cmimet dhe sasite, duhet të shprehen në euro (€), përveç rasteve kur mund të kërkohen ndryshe nga ligji apo rregulloret në fuqi.
4. Pagesa do të vendoset në datën në të cilën shuma e dhënë është kredituar në llogarinë e përfituesit. Çdo interes për pagesa të vonuara, do të konsiderohet si i shlyer në datën kur pagesa është kredituar nga llogaria e paguesit.
5. Pagesat do të bëhen në euro (€).
6. Platforma e Alokimit do të marrë parasysh taksat dhe tatimet në shkallën dhe në masën e zbatueshme, gjatë fazës së vlerësimit të detyrimeve të pagesave dhe lëshimit të faturave, mbështetur në këto Rregulla të Alokimit, në përputhje me Nenin 48.
7. Pjesëmarrësi i Regjistruar duhet t'i sigurojë Platformës së Alokimit informacionin përkatës, i cili lidhet me justifikimin nëse tatimet dhe taksat përkatëse janë të zbatueshme ose jo, në momentin kur nënshkruajnë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes, si dhe çdo ndryshim që mund të ketë në këtë drejtim, pa vonesa. Prandaj, është detyrimi i Pjesëmarrësit të Regjistruar të informojë Platformën e Alokimit për çdo taksë dhe tatim vendor, brenda komunitetit ose jashtë komunitetit, të cilat janë në përputhje me legjislacionin e vendit të themelimit të Pjesëmarrësit të Regjistruar.

Neni 47

Llogaritja e detyrimeve te caktuara

1. Pjesëmarrësit e Regjistruar duhet të paguajnë për secilën prej të Drejtave Ditore të Transmetimit që u është alokuar atyre, për çdo orë individualisht, shumë e cila llogaritet si:
 - (a) Çmimi marxhinal (për MË në orë); shumëzuar me
 - (b) Të Drejtat Ditore të Transmetimit në MË të alokuara në orë individuale të ditës.
2. Të Drejtat Ditore të Transmetimit do të faturohen në bazë mujore. Platforma e alokimit do të llogarisë shumën e detyrimeve te caktuara që duhet të paguhet në mënyrë në retrospektivë për muajin paraardhës. Shuma e detyrimeve, plus çdo taksë e tatim i aplikueshëm, ose detyrime të tjera që mbështeten në Nenin 48, do të rumbullakoset deri në dy numra pas presjes dhjetore.

Neni 48

Tatimi Bruto

1. Secili pjesëmarrës i Regjistruar duhet të bëjë të mundur që të gjitha pagesat që ai realizon, të bëhen sipas rregullave të alokimit, pa asnjë zbritje të tatimeve, përveç rasteve nëse kërkohet me ligj zbritja e tatimit.

2. Nëse heqja e vlerës së tatimit i kërkohet me ligj një pjesëmarrësi të Regjistruar, shuma e detyrimit të pagesës që ka pjesëmarrësi i Regjistruar kunderejt Platformës së alokimit, do të rritet në një vlerë të tillë që (pas kryerjes së zbritjes së vlerës së tatimit) të ketë një shumë të barabartë me pagesën e cila do të kishte qenë e detyrueshme për tu paguar, në rast se nuk do të ishte kërkuar zbritja tatimore.
3. Paragrafi 2 i këtij neni nuk zbatohet në lidhje me ndonjë tatim të vlerësuar në Platformën e Alokimit për çdo pagesë të marrë në lidhje me Rregullat e Alokimit sipas ligjeve të juridiksionit në të cilin Platforma e Alokimit është inkorporuar ose perndryshe juridiksionet në të cilat Platforma e Alokimit trajtohet si rezident, konsiderohet që për qëllime tatimore të ketë një seli të përhershme ose një vend fiks biznesi në të cilin çdo pagesë i atribuohet sipas Rregullave të Alokimit. Paragrafi 2 i këtij neni nuk zbatohet për tatimin mbi vlerën e shtuar (siç parashikohet në direktivën e TVSH-së 2006/112 / EC ose, siç mund të jetë, çdo legjislacion kombëtar i ngjashëm, i ndryshuar herë pas here) dhe çdo taksë tjetër se njejtës natyre.

Neni 49

Kushtet e pageses dhe faturimit

1. Platforma e Alokimit do të lëshojë fatura mbi pagesat e të gjithë të Drejtave Ditore të Transmetimit, në bazë mujore dhe jo më vonë se dhjetë ditë pune (10) për çdo muaj, për Ankandet e muajit që vijojnë.
2. Faturat lëshohen për pagesat në vijim:
 - (a) shumën e përcaktuar sipas Nenit 47 (2);
 - (b) çdo tatim dhe taksë relevante që i nënshtrohet Nenit 48.
3. Platforma e Alokimit do t'i dërgojë faturën me mjete elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit, në adresën elektronike të personit financiar të kontaktit të paraqitur në përputhje me Nenin 8 (1) (h) ose duhet ta vërë atë në dispozicion të Pjesëmarrësit të Regjistruar përmes Programit të Ankandit. Data e lëshimit të faturës do të jetë data në të cilën fatura dërgohet me mjete elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit ose data kur fatura është bërë e disponueshme përmes Programit të Ankandit, nëse kjo bëhet gjatë orarit të punës, ose të nesërmen nëse dërgohen pas orarit të punës.
4. Pagesat mund të netohet nga Platforma e Alokimit, , duke marrë parasysh shumën e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij Neni, dhe çdo shumë tjetër të pagueshme nga Platforma e Alokimit për Pjesëmarrësit e Regjistruar, si rezultat i proceseve të alokimit të kryera nga Platforma e Alokimit.
5. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të shlyejë detyrimet e pagesës që rrjedhin nga paragrafi 2 ose paragrafi 4 i këtij Neni, brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së lëshimit të faturës.
6. Pagesat nga pjesëmarrësi i Regjistruar, do të vendosen në Llogarinë e Biznesit të Platformës së Alokimit sipas specifikimeve në faturë, duke paraqitur edhe referencën e

faturës, ashtu sic është specifikuar në paragrafin 5 të këtij Neni, ose në të kundërt, Platforma e Alokimit do të mbledhë pagesën automatikisht nga Llogaria e dedikuar e Biznesit të Pjesëmarrësit të Regjistruar në datën përkatëse të faturës.

7. Platforma e alokimit do të caktojë detyrimet e pagesave që rrjedhin nga paragrafi 4 i këtij Neni, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas datës së marrjes së faturës, duke paguar shumën në llogarinë bankare e cila është shpallur gjatë procesit të pranimit nga pjesëmarrësi i Regjistruar, në përputhje me Nenin 8 paragrafi 1 (g) i cili ka të drejtën për shlyerjen e pagesave në datën e caktuar.
8. Pas grumbullimit të pagesave, siç është përcaktuar në paragrafin 6 të këtij Neni, Platforma e Alokimit do të përditësojë Limitin e Kreditit në përputhje me rrethanat e mësipërme.
9. Në rast të kompilimit të një fature të gabuar, e cila mund të rezultojë në një pagesë shtesë të Platformës së Alokimit ose të Pjesëmarrësit të Regjistruar, atëherë Platforma e Alokimit do të korrigjojë faturën si dhe çdo shumë e caktuar do të zgjidhet sapo të jenë njoftuar Pjesëmarrësin e Regjistruar.
10. Të gjitha pagesat bankare mbulohen nga pjesëmarrësi i Regjistruar.
11. Pjesëmarrësi i Regjistruar nuk do të ketë të drejtë të kompensojë ndonjë shumë, ose të refuzojë ndonjë borxh, të cilat mund të vijnë si pasojë e detyrimeve që rrjedhin nga një procedurë Ankandi, përkundrajt çdo pretendimi ndaj Platformës së Alokimit, pavarësisht nëse janë apo jo rezultate që dalin nga Ankandi. Sidoqoftë, e drejta për të kompensuar dhe e drejta për të refuzuar nuk përjashtohet, në rast se kërkesa e pjesëmarrësit të Regjistruar në Platformën e Alokimit është vendosur me një akt nënligjor ose është i pakontestueshëm.

Neni 50

Pagesat kontestuese

1. Një pjesëmarrës i Regjistruar mund të kontestojë shumën e një fature, duke përfshirë çdo shumë që do mund t'i kreditohet atij. Në këtë rast, pjesëmarrësi i Regjistruar do të njoftojë në Platformën e Alokimit sa më shpejt të jetë e mundur, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas datës së lëshimit të faturës ose njoftimit të kredisë nëpërmjet postës dhe mjete elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit. Përtej kësaj periudhe, fatura konsiderohet të jetë pranuar nga pjesëmarrësi i Regjistruar.
2. Nëse Pjesëmarrësi i Regjistruar dhe Platforma e Alokimit nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen e diferencës së pagesave, brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas njoftimit, atëherë do të zbatohet procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në përputhje me Nenin 54.
3. Mosmarrëveshja në lidhje me shumën e faturës nuk do të clirojë në asnjë mënyrë asnjë nga Palët, nga detyrimi për të paguar shumat e tilla që ato i detyrohen njëri tjetrit në përputhje me Nenin 49.

4. Nëse palët janë dakordësuar, ose sic është përcaktuar në bazë të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në Nenin 54, që shuma e paguar ose e pranuar nga pjesëmarrësi i Regjistruar nuk është paguar siç duhet, do të zbatohet procesi në vijim:
 - a. Platforma e Alokimit do t'i rimbursojë çdo shumë duke përfshirë edhe interesin që do të llogaritet sipas Nenit 46 (4) Pjesëmarrësit të Regjistruar në rast se shuma e paguar nga Pjesëmarrësi i Regjistruar siç përcaktohet në Nenin 49 (5) do të jetë më e lartë ose shuma e paguar nga Platforma e Alokimit ishte më e ulët se shuma e duhur. Platforma e alokimit do ta bëjë pagesën në llogarinë bankare të treguar nga pjesëmarrësi i Regjistruar për këtë rimbursim në përputhje me Nenin 8 paragrafi 1 (g).
 - b. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të paguajë çdo shumë duke përfshirë interesin i cili do të llogaritet sipas Nenit 46 (4) të Platformës së Alokimit në rast se shuma e paguar nga Pala e Regjistruar e përcaktuar në Nenin 49 (5) ishte më e ulët, ose shuma e paguar nga Platforma e Alokimit ishte më e lartë se shuma e caktuar. Pjesëmarrësi i Regjistruar do të bëjë pagesën në përputhje me procedurën e përcaktuar në Nenin 49 (6). Pas kësaj pagese, Platforma e Alokimit do të azhurnojë Limitin e Kreditit të Pjesëmarrësit të Regjistruar, siç përcaktohet në Nenin 49 (8)
5. Interesi i paguar në rast të një pagese në përputhje me paragrafin 4 të këtij Neni zbatohet që nga dita e parë (1) pas datës në të cilën pagesa ka qenë deri në datën në të cilën shuma kontestuese është kthyer dhe ajo do të zbatohet edhe për të gjitha tatimet dhe taksat e kërkuara me ligj.

Neni 51

Pagesa me vonese dhe incidente ne pagese

1. Në rast se Pjesëmarrësi i regjistruar nuk ka paguar plotësisht faturën në datën e përcaktuar, Platforma e Alokimit do të njoftojë Pjesëmarrësin e Regjistruar se një incident në pagesë do të regjistrohet nëse shuma e caktuar përfshirë dhe interesin e aplikuar nuk është marrë brenda tre (3) Ditëve të Punës pas dërgimit të njoftimit. Në rast se nuk kryhet pagesa brenda Afatit, Platforma e Alokimit do të njoftojë Pjesëmarrësin se Incidenti është regjistruar.
2. Menjëherë pas rregjistrimit të incidentit të pagesës Platforma e Alokimit mund të përdorë kolaterale.
3. Platforma e Alokimit mund të pezullojë ose të ndërpresë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në rast incidenti pagese të regjistruar në përputhje me Nenin 55 dhe 56.
4. Në rast të pagesës së vonuar ose rimbursimit, Palët do të paguajnë interes të shumës duke përfshirë dhe taksat që nga dita e parë (1) pas datës në të cilën duhet të kryer

pagesa deri në datën në të cilën bëhet pagesa. Interesi duhet të jetë i barabartë sasinë më të lartë të:

(a) Një normë fikse prej 100 €; ose

(b) Tetë (8) përqind në vit mbi normën e interesit të referencës publikuar zyrtarisht nga autoritetet kombëtare të vendit në të cilin Platforma e Alokimit është vendosur dhe të rrumbullakosura deri në gjysmën më të afërt të përqindjes.

KAPITULLI 9

Neni 52

Kohezgjatja dhe amendimi i rregullave të alokimit

1. Rregullat e Alokimit janë me kohëzgjatje të pacaktuar dhe i nënshtrohen ndryshimit në përputhje me këtë Nen. Këto Rregulla dhe çdo ndryshim i tyre do të konsultohen në bazë të paragrafit 7 të këtij Neni, të propozuara nga Operatorët përkatës të Sistemit të Transmetimit dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me regjimin rregullator kombëtar të zbatueshëm. Platforma e Alokimit do të publikojë Rregullat e Alokimit të ndryshuar dhe do të dërgojë një njoftim ndryshimi për Pjesëmarrësit e Regjistruar.
2. Objekti i paragrafit 7 të këtij neni, një ndryshim do të hyjë në fuqi në datën dhe kohën e përcaktuar në njoftimin e ndryshimit, por jo më herët se tridhjetë (30) ditë kalendarike pasi njoftimi i ndryshimit të jetë dërguar Pjesëmarrësve të Regjistruar nga Platforma e Alokimit.
3. Çdo amendim do të zbatohet në të gjitha aspektet e këtyre Rregullave të Alokimit, duke përfshirë, por pa u limituar në të gjitha Ankandet e kryera pas datës në të cilën ndryshimi hyn në fuqi.
4. Përveç nëse përcaktohet shprehimisht ndryshe nga Platforma e Alokimit, Rregullat e Alokimit të ndryshuara do të qeverisin të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me këto Rregulla të Alokimit përfshirë ato të fituara para datës së ndryshimit, por me datën e dorëzimit pas hyrjes në fuqi të ndryshimit.
5. Çdo ndryshim i Rregullave të Alokimit do të zbatohet automatikisht në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në fuqi ndërmjet Platformës së Alokimit dhe Pjesëmarrësit të Regjistruar, pa pasur nevojë që Pjesëmarrësi i regjistruar të nënshkruajë një Marrëveshje të re të Pjesëmarrjes, por pa paragjykuar të drejtën e Pjesëmarrësit të Regjistruar për të kërkuar ndërprerjen e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në përputhje me Nenin 6 (1). Duke marrë pjesë në ankand pasi pjesëmarrësi i regjistruar është informuar për ndryshimet dhe/ose përshtatjet e rregullave të alokimit dhe pasi këto ndryshime dhe/ose përshtatje të hyjnë në fuqi, konsiderohet se pjesëmarrësi i regjistruar ka pranuar ndryshimet, dhe Versionin efektiv të Rregullave të Alokimit si të vlefshme.
6. Rregullat e Alokimit do të rishikohen periodikisht nga Platforma e Alokimit, nga Operatorët përkatës të Sistemit të Transmetimit, të paktën çdo dy vjet, duke përfshirë dhe Pjesëmarrësit e Regjistruar. Në rast se Operatorët e Sistemit të Transmetimit konsiderojnë ndryshimin e këtyre Rregullave të Alokimit si rezultat i këtij rishikimi,

zbatohet procedura e përshkruar në këtë Nen. Ky shqyrtim dyvjeçar nuk cenon kompetencën e Autoriteteve Rregullatore Kombëtare për të kërkuar në çdo kohë ndryshimet e Rregullave të Alokimit dhe anekset e përfshira në to në përputhje me legjislacionin ekzistues.

7. Rregullat e Alokimit i nënshtrohen legjislacionit që ekziston në kohën kur ato hyjnë në fuqi. Në rast se ka një ndryshim në legjislacion ose ndonjë veprim nga autoritetet kompetente në nivel kombëtar, ose në nivel të Bashkimit European ose, siç mund të jetë, në nivelin e Komunitetit të Energjisë që kanë efekt në këto Rregulla të Alokimit dhe / ose në anekset e tyre, pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e këtyre Rregullave të Alokimit, Rregullat e Alokimit do të ndryshohen në përputhje me këtë nen.
8. Lista e kufijve të Zonës së Ofertimit (Shtojca 1) në të cilën zbatohen Rregullat e Alokimit mund të ndryshohet ose të plotësohet në përputhje me dispozitat që kanë të bëjnë me ndryshimin e Rregullave të Alokimit, me kusht që aty ku ndryshimi i kësaj liste është aprovuar, të kërkohej miratimi i një ose më shumë NRA-ve.
9. Me qëllim përfshirjen e ndryshimit ose plotësimit, vetëm aprovimi i NRA-s ka juridiksion mbi TSO-te përkatëse për të cilat kufiri i zonës së ofertimit është ndryshuar ose shtuar. Duhet të kërkohej konsultimi ose miratimi, sipas rastit.

Neni 53

Detyrimet

1. Platforma e Alokimit dhe Pjesëmarrësit e Regjistruar janë përgjegjës vetëm për përmbushjen e çdo detyrimi që ata ndërmarrin ose janë subjekt i asaj cka rrjedh prej detyrimit që lidhet me Rregullat e Alokimit dhe Marëveshjen e Pjesëmarrjes.
2. Në varësi të ndonjë dispozite tjetër të këtyre Rregullave të Alokimit, Platforma e Alokimit do të jetë përgjegjëse vetëm për dëmet e shkaktuara nga:
 - (a) Mashtrimi, neglizhenca e madhe ose sjelljet e pahijshme.
 - (b) Vdekjen ose dëmtimin personal që rrjedh nga neglizhenca e tij ose e punonjësve të tij, agjentët ose nënkontraktorët.
3. Një Pjesëmarrës i Regjistruar do të dëmshpërblejë dhe do të mbajë te dëmshpërblyer Platformën e Alokimit, punonjësit dhe agjentët e saj kundër çdo humbjeje ose detyrimi (duke përfshirë kostot ligjore) që lidhen me dëmin që ka shkaktuar. Dëme që ndonjëri prej palëve të mësipërme mund të pësojë si rrjedhojë e çdo kërkesë nga ndonjë palë e tretë për shkak të çfarëdo humbjeje (të drejtpërdrejta ose të tërthorta) të pësuar nga paraqitësi i kërkesës ose ndonjë nga oficerët, agjentët, nënkontraktorët ose punonjësit e paraqitësit të kërkesës në lidhje me këto Rregulla të Alokimit.
4. Platforma e Alokimit dhe secili Pjesëmarrës i Regjistruar pranon dhe pajtohet me benefitet e paragrafit 3 të këtij Neni për vete dhe si administrues i besuar për punonjësit dhe agjentët e tij.
5. Pjesëmarrësi i regjistruar do të jetë vetëm përgjegjës për pjesëmarrjen e tij në ankand duke përfshirë por jo kufizuar në rastet e mëposhtme:
 - (a) Ardhjen në kohë të ofertave dhe transferimin dhe kthimin e njoftimeve nga

Pjesëmarrësi i Regjistruar;

(b) Dështimin teknik të sistemit të informacionit në anën e Pjesëmarrësit të regjistruar duke mos lejuar komunikimin nëpërmjet kanaleve të parashikuara në përputhje me Rregullat e Alokimit.

6. Pjesëmarrësi i regjistruar do të jetë përgjegjës në lidhje me sanksionet, gjrobat ose akuzat që mund të vendosen nga autoritetet financiare në Platformën e Alokimit për trajtim të pasaktë tatimor për shkak të informatave të gabuara ose jo të plota të ofruara nga Pjesëmarrësi i Regjistruar.
7. Ky nen shpeton me përfundimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes së Pjesëmarrësit të Regjistruar

Neni 54

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Pa cenuar paragrafët 6 dhe 8 të këtij neni, ku ka një mosmarrëveshje Platforma e Alokimit dhe Pjesëmarrësi i regjistruar së pari duhet të kërkojë zgjidhje miqësore nëpërmjet konsultimeve reciproke në përputhje me paragrafin 2. Për këtë qëllim, Pala që ngre mosmarrëveshjen do të dërgojë një njoftim Palës tjetër duke i treguar:
 - (a) Ekzistencën e një Marrëveshjes së Pjesëmarrjes ndërmjet Palëve;
 - (b) arsyen e mosmarrëveshjes; dhe
 - (c) një propozim për një mbledhje të ardhshme, fizike ose jo, me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes miqësisht.
2. Palët do të takohen brenda njëzet (20) ditëve të punës pasi çështja t'iu referohet atyre dhe të kërkohet të zgjidhet mosmarrëveshja. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje ose nuk ka përgjigje të marra brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditëve të punës nga data e njoftimit të lartpërmendur, secila Palë mund ta delegojë çështjen në instance më të larta menaxheriale të Palëve për të zgjidhur mosmarrëveshjen në pajtim me paragrafin 3.
3. Përfaqësuesit e secilës prej Platformave së Alokimit dhe Pjesëmarrësve të Regjistruar, me autorizim zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të takohen brenda njëzet (20) Ditëve të Punës për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Nëse përfaqësuesit nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen brenda njëzet (20) ditëve të punës të takimit ose më shumë kohë sic mund të bihet dakort, atëherë mosmarrëveshja do të përcaktohet nga arbitrazhi në përputhje me paragrafin 4.
4. Kur një mosmarrëveshje duhet t'i referohet arbitrazhit sipas paragrafit 3, Platforma e Alokimit ose Pjesëmarrësi i regjistruar mund të njoftojë tjetrin duke deklaruar natyrën e mosmarrëveshjes dhe duke i referuar mosmarrëveshjes në arbitrazh. Arbitrazhi kryhet në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë (ICC). Arbitrazhi kryhet përpara se një (1) arbitër të emërohet me marrëveshje të Palëve, përveç nëse një Palë kërkon emërimin e tre (3) arbitrave. Në rast të një (1) arbitrit, palët do të bien dakord për emërimin e arbitrit brenda dy (2) muajve pasi është dhënë njoftimi nga pala referuese mosmarrëveshjes në arbitrazh. Nëse nuk mund të gjendet asnjë marrëveshje, arbitri do të emërohet nga Gjykata e ICC-së. Në rastin e tre (3) arbitrave, paraqitësi i

- kërkesës propozon një (1) arbitër dhe i padituri emëron një (1) arbitër. Arbitrat të emëruar nga secila palë më pas do të propozojnë kryetarin e tribunalit të arbitrazhit brenda tri (3) ditëve të punës nga konfirmimi i emërimit të arbitrazhit të dytë nga i padituri. Arbitrat e emëruar nga secila palë nuk mund të bien dakord për emërimin e kryetarit, kryetari emërohet nga Gjykata e ICC-së. Arbitrimi do të zhvillohet në vendin e Platformës së Alokimit përveç nëse përcaktohet ndryshe në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes dhe në përputhje me ligjin e qeverisjes së këtyre Rregullave të Alokimit, ndërsa gjuha e procedurës së arbitrazhit do të jetë anglisht. Dispozitat e arbitrazhit të jashtëzakonshëm sipas Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë nuk zbatohen, por do të zbatohen masat e ndihmës së përkohshme ose urdhërdhënës sipas ligjit në fuqi.
5. Çmimet e arbitrazhit do të jenë përfundimtare dhe të detyrueshme për Platformën e Alokimit dhe pjesëmarrësit përkatës të regjistruar që nga data kur ato janë kryer. Platforma e Alokimit dhe Pjesëmarrësi i Regjistruar do të kryejnë çdo detyrim të një arbitrazhi në lidhje me çdo mosmarrëveshje pa vonesë dhe secila palë do të heqë dorë nga e drejta e tyre për çdo formë të ankesës ose rekursit në një gjykatë ose autoritet tjetër gjyqësor, për aq kohë sa kjo bëhet e vlefshme.
 6. Pavarësisht nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, Palët mund të bien dakord bashkërisht për të zbatuar procedurat gjyqësore në vend të arbitrazhit për të zgjidhur një mosmarrëveshje që lind në lidhje me këto Rregulla të Alokimit.
 7. Në rastet e pagesës së vonuar dhe Pavarësisht nga neni 51 dhe paragrafët 1 deri në 4 të këtij neni, një Palë mund të sjellë procedurat gjyqësore kundër palës tjetër për çdo shumë të papaguar për më shumë se njëzet (20) ditë pune.
 8. Palët bien dakord që procedurat e referuara në paragrafët 6 ose 7 të këtij neni mund të ngrihen në ndonjë gjykatë kompetente për të dëgjuar kërkesën. Pjesëmarrësi i regjistruar në mënyrë të pakthyeshme heq dorë nga çdo kundërshtim që mund të ketë tani ose në të ardhmen lidhur me vendin e gjykimit në ndonjë gjykatë kompetente dhe çdo pretendim që ndonjë procedurë e tillë është sjellë në një forum të papërshtatshëm.
 9. Pavarësisht nga ndonjë referencë për zgjidhje miqësore, zgjidhjen e ekspertëve ose arbitrazhin sipas këtij Neni, Platforma e Alokimit dhe Pjesëmarrësi i regjistruar do të vazhdojnë të kryejnë obligimet e tyre përkatëse sipas këtyre Rregullave të Alokimit dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes së Pjesëmarrësit të Regjistruar.
 10. Ky nen qëndron në fuqi me përfundimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes së Pjesëmarrësit të Regjistruar.

Neni 55

Pezullimi i Marrëveshjes së Pjesëmarrjes

1. Platforma e Alokimit mundet me anë të njoftimit të Pjesëmarrësit të Regjistruar të pezullojë përkohësisht të drejtat e tij në lidhje me këto Rregulla të Alokimit me efekt të menjëhershëm. Kjo bëhet në rastet që Pjesëmarrësi i Regjistruar kryen një shkelje të madhe të një detyrimi në lidhje me këto Rregulla të Alokimit, shkelje që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në Platformën e Alokimit. Shkeljet mund të jenë si më poshtë:

- (a) Nëse një Pjesëmarrës i Regjistruar nuk paguan shumën e duhur sipas Nenit 51;
 - (b) Nëse një Pjesëmarrës i regjistruar nuk arrin të ofrojë dhe të mbajë kolateral në përputhje me Nenin 23;
 - (c) Çdo shkelje që mund të ketë një ndikim të rëndësishëm financiar në Platformën e Alokimit;
 - (d) Platforma e Alokimit ka baza të arsyeshme për të besuar se Pjesëmarrësi i Regjistruar nuk plotëson më një ose më shumë kushte të tjera për të marrë pjesë në Ankandet sipas këtyre Rregullave të Alokimit vetëm nëse ndërprerja aplikohet në përputhje me Nenin 56; dhe
- (a) nëse Pjesëmarrësi i Regjistruar është nën sanksione ekonomike dhe tregtare të cilat mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në Platformën e Alokimit.
2. Në çdo rast të shkeljes së lehtë në lidhje me këto Rregulla të Alokimit siç janë, por pa u kufizuar në dështimin e Pjesëmarrësit të Regjistruar për të njoftuar një ndryshim në informacionin e dorëzuar në përputhje me Nenin 8, Platforma e Alokimit mund të njoftojë Pjesëmarrësit e regjistruar që të drejtat e tij në lidhje me këto Rregulla të Alokimit mund të pezullohen nëse Pjesëmarrësi i Regjistruar nuk korrigjon ngjarjen e pezullimit në periudhën kohore të specifikuar në njoftim. Pezullimi do të hyjë në fuqi kur periudha e specifikuar për mjetin juridik ka kaluar ndërkohë që zgjidhja nuk ka ndodhur. Pasi pezullimi të hyjë në fuqi në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Pjesëmarrësi i regjistruar i pezulluar nuk mund të marrë pjesë më në ankand.
 3. Platforma e alokimit mund të anullopë një njoftim nga paragrafët 1 ose 2 të këtij neni në çdo kohë. Pasi të ketë dhënë një njoftim sipas paragrafëve 1 ose 2 të këtij Neni, Platforma e Alokimit mund të japë një njoftim tjetër në çdo kohë në lidhje me të njëjtën ngjarje ose një pezullim tjetër ngjarjeje.
 4. Pasi Pjesëmarrësi i regjistruar të ketë përmbushur ose korrigjuar ngjarjen e pezullimit siç është lajmëruar në njoftimin e dërguar nga Platforma e Alokimit, kjo e fundit do të rivendosë sa më shpejt që të jetë e mundur të drejtat e tij për të marrë pjesë në ankand. Që nga data e hyrjes në fuqi, Pjesëmarrësi i regjistruar mund të marrë pjesë në ankandet
 5. Nëse Platforma e Alokimit i njofton një Pjesëmarrësi të Regjistruar sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij Neni, njoftimi i pezullimit nuk e liron pjesëmarrësin e regjistruar nga detyrimet e tij të pagesës sipas KAPITULLI 8.

Neni 56

Ndërprerje e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes

1. Një pjesëmarrës i regjistruar mund të kërkojë në çdo kohë përfundimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në të cilën pjesëmarrësi i regjistruar është një Palë. Ndërprerja do të hyjë në fuqi pas tridhjetë (30) ditëve të punës pas pranimit të kërkesës për ndërprerje nga Platforma e Alokimit dhe nëse të gjitha detyrimet e pagimit të papaguara janë të shlyera.

2. Një Pjesëmarrës i regjistruar mund të përfundojë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në të cilën është Palë kur Platforma e Alokimit ka kryer një shkelje të rëndë të një detyrimi lidhur me këto Rregulla për Alokim ose me Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në rastet e mëposhtme:

- (a) Ku Platforma e Alokimit në mënyrë të përsëritur nuk paguan një shumë të caktuar me një ndikim të rëndësishëm financiar;
- (b) Ku ka një shkelje të konsiderueshme të detyrimeve të konfidencialitetit në përputhje me nenin 59.

Pjesëmarrësi i regjistruar do të dërgojë një njoftim në Platformën e Alokimit duke deklaruar arsyet për përfundimin dhe duke i dhënë Platformës së Alokimit njëzet (20) Ditë Pune për të korrigjuar shkeljen. Përveç rasteve që Platforma e Alokimit korrigjon shkeljen brenda rasteve që u përmendën më sipër afati përfundimtar do të hyjë në fuqi menjëherë pas skadimit të afatit të përcaktuar.

3. Nëse ndonjë nga ngjarjet e Ndërprerjes në paragrafin 4 ndodh në lidhje me një Pjesëmarrës të Regjistruar, Platforma e Alokimit njofton Pjesëmarrësin të Regjistruar të ndërpresë Marrëveshjen e Pjesëmarrjes, duke përfshirë të drejtat e Pjesëmarrësit të Regjistruar lidhur me këto Rregulla të Alokimit. Një ndërprerje sipas këtij paragrafi hyn në fuqi nga koha e njoftimit ose ndonjë kohë më vonë të përcaktuar në të. Pjesëmarrësi i regjistruar në fazën e mëvonshme nuk mund të hyjë në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes derisa rrethanat e ndërprerjes të vazhdojnë të ekzistojnë ose nuk është e garantuar në mënyrë të mjaftueshme që shkelja nuk mund të ndodhë përsëri.
4. Ngjarjet e përfundimit të përmendura në paragrafin 3 do të jenë si më poshtë:
 - (a) Nëse të drejtat e Pjesëmarrësit të regjistruar janë pezulluar për më shumë se tridhjetë (30) Dite pune;
 - (b) Nëse Pjesëmarrësi i regjistruar nuk kualifikohet për pjesëmarrjen në ankand sipas nenit 9;
 - (c) Nëse një Pjesëmarrës i Regjistruar në mënyrë të përsëritur i shkel këto Rregulla për Alokim ose Marrëveshjen për Pjesëmarrje, pavarësisht nëse shkelja është ose jo e korrigjueshme;
 - (d) Nëse një autoritet kompetent (i) përcakton se pjesëmarrësi i regjistruar ka kryer Një keqpërdorim ose akt mashtrues dhe (ii) kërkon që Platforma e Alokimit të përfundojë (Iii) pajtohet që Platforma e Alokimit ka baza të arsyeshme për të besuar se Pjesëmarrësi i Regjistruar ka kryer një keqpërdorim ose veprim mashtrues në pjesëmarrjen në ankandet; ose
 - (e) Nëse Pjesëmarrësi i regjistruar ka ndërmarrë ndonjë veprim që mund të çojë në dëmtimin ose Reduktimin e efektivitetit të ankandit (si psh në rast të ndonjë sjelljeje që mund të vijë nga një Sulm në sistemin e informacionit si, por pa u kufizuar në, mohimin e shërbimit, spam, Virus,).
5. Pasi ndërprerja të hyjë në fuqi në përputhje me paragrafët 1 deri 3 të këtij neni dhe që nga ajo kohë, Pjesëmarrësi i regjistruar nuk mund të marrë pjesë më në ankand.
6. Ndërprerja e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes nuk ndikon në asnjë të drejtë dhe obligim në lidhje me Marrëveshjen e Pjesëmarrjes dhe me Rregullat e Alokimit që u ngritën përpara kësaj ndërprerjeje, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Nen. Prandaj, çdo

Pjesëmarrës i Regjistruar, Marrëveshja e Pjesëmarrjes së të cilit përfundon, do të mbetet përgjegjës, subjekt i dhe në përputhje me Rregullat e Alokimit, në lidhje me të gjitha këto të drejta dhe detyrime. Ky paragraf do të zbatohet pa paragjykuar mjetet e tjera në dispozicion të Platformës së Alokimit sipas këtyre Rregullave të Alokimit.

Neni 57

Forca Madhore

1. Platforma e Alokimit ose një Pjesëmarrës i Regjistruar, i cili thirret në Forcën Madhore, menjëherë do t'i dërgojë Palës tjetër një njoftim që përshkruan natyrën e Forcës Madhore dhe kohëzgjatjen e mundshme të tij dhe do të vazhdojë të japë raporte në lidhje me to me frekuencë të arsyeshme gjatë periudhës së Forcës Madhore . Pala që thirret në Forcën Madhe do të bëjë çdo përpjekje të mundshme për të kufizuar pasojat e Forcës Madhore.
2. Detyrimet dhe të drejtat e një Pale, që janë objekt i Forcës Madhore, pezullohen që nga fillimi i Forcës Madhore, me përjashtim të dispozitave të konfidencialitetit në përputhje me nenin 59.
3. Pezullimi sipas paragrafit 2 është subjekt i:
 - (a) Pezullimi nuk do të jetë më i madh dhe nuk ka më tepër kohëzgjatje se sa kërkohet nga Forca Madhore;
 - (b) Pezullimi vlen vetëm për atë kohë sa Pala që thirret në Forcën Madhore është duke u përpjekur të korrigjojë paaftësinë e saj për të performuar.
4. Pasojat e një ngjarjeje të Forcës Madhore, e cila nuk është subjekt i ndonjë diskutimi ndërmjet Platformës së Alokimit dhe Pjesëmarrësit të Regjistruar, janë:
 - (a) Pala që thirret me Forcë Madhore nuk mund të konsiderohet përgjegjës për të paguar kompensimin për çdo dëm të pësuar për shkak të moszbatimit ose performancës së pjesshme të të gjitha ose disa prej detyrimeve të saj gjatë Forcës Madhore dhe kur ky mosfunksionim ose performancë e pjesshme lidhet drejtpërdrejtë me Forcën Madhore;
 - (b) Të Drejtat e Transmetimit të Fituara që janë paguar dhe janë subjekt i Forcës Madhore, rimbursohen për kohëzgjatjen e Forcës Madhore në përputhje me çdo legjislacion të zbatueshëm; dhe
 - (c) Nëse Forca Madhore vazhdon për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj, Platforma e Alokimit ose secili Pjesëmarrës i Regjistruar mund të njoftojë tjetrin të zgjidhë në mënyrë të njëanshme Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në çdo kohë kur Forca Madhore vazhdon përtej asaj periudhe. Ndërprerja do të hyjë në fuqi dhjetë (10) Ditë Pune pas njoftimit ose ndonjë datë të mëvonshme të specifikuar në njoftim.
 - (d) Për shmangien e dyshimit, ky nen nuk cenon dispozitat e KAPITULLIT 7 në lidhje me kufizimin e të Drejtave të Transmetimit Ditor

Neni 58

Njoftime

1. Çdo njoftim ose komunikim tjetër që do të jepet nën ose në lidhje me këto Rregulla të Alokimit duhet të jetë në Anglisht.
2. Përveç nëse parashikohet shprehimisht ndryshe në këto Rregulla të Alokimit, të gjitha njoftimet ose komunikime të tjera duhet të bëhen me shkrim midis Platformës së Alokimit dhe çdo Pjesëmarrësi të Regjistruar dhe do të dërgohen në me mjete elektronike siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit që është përcaktuar në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes ose siç njoftohet nga Pjesëmarrësi i Regjistruar herë pas here në përputhje me Nenin 8.
3. Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera duhet të jepen me letër dorazi përkundrejt një konfirmimi ose të dërgohen me postë ose me korrier për rastet e mëposhtme:
 - (a) Përfundimin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në përputhje me Nenin 6;
 - (b) Pezullimi dhe përfundimi sipas nenit 56 dhe nenit 55; dhe
 - (c) Dorëzimi i garancisë bankare, , në rast se Garancia Bankare përfshin nënshkrimin(et) me shkrim dore, në përputhje me nenin 19.
4. Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera do të konsiderohen si të pranuar:
 - (a) Në rastin e dorëzimit me dorë, kundrejt një konfirmimi; ose
 - (b) Në rastin e postës me parapagim të dorëzimit të regjistruar, në ditën pasardhëse të datës së regjistruar për dërgim ose,
 - (c) Në rastin e mjeteve elektronike të specifikuara nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit, kur i dorëzohet palës tjetër, por vetëm nëse kërkohet dhe merret konfirmimi i marrjes nga Pala që dërgon mjetet elektronike të specifikuara nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit
5. Nëse një njoftim ose komunikim tjetër është marrë jashtë orarit normal të punës, konsiderohet se është marrë në ditën e ardhshme të punës.

Neni 59

Konfidencialiteti

1. Marrëveshja e Pjesëmarrjes dhe çdo informacion tjetër i shkëmbyer në lidhje me përgatitjen e tij dhe aplikimin e një Pjesëmarrësi të tregut do të konsiderohet konfidencial.
2. Në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, Platforma e Alokimit dhe çdo Pjesëmarrës i Regjistruar, i cili është marrës i informacioneve konfidenciale në lidhje me këto Rregulla për Alokim, duhet të ruajë konfidencialitetin e informacionit të tillë dhe nuk do të zbulojë, raportojë, publikojë, transferojë Ose të përdorë çdo element të informacionit konfidencial ndryshe nga qëllimi për të cilin është bërë i ditur.
3. Pavarësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, Platforma e Alokimit ose Pjesëmarrësi i regjistruar mund të zbulojë informacionin konfidencial të një njëres Pale në dispozicion të një pale të tretë me pëlqimin paraprak të saj të shprehur me shkrim dhe me kusht që

Pala pritëse të ketë dhënë siguri se një palë e tretë e tillë është e lidhur me detyrime të barasvlershme të konfidencialitetit siç janë përcaktuar në këto Rregulla Alokimi.

4. Pavarësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, Platforma e Alokimit ose Pjesmarsi i Regjistruar mund të zbulojë informacionin konfidencial të një pale që deklaroi:

- (a) Në masën e lejuar ose parashikuar shprehimisht nga Rregullat e Alokimit;
 - (b) Për çdo person që është një nga drejtorët, zyrtarët, punonjësit, agjentët, këshilltarët dhe që duhet të njohin informacionin konfidencial në lidhje me këto Rregulla të Alokimit;
 - (c) Për aq sa kërkohet për të përmbushur legjislacionin e BE-së (siç është Rregullorja (EU) Nr 1227/2011 dhe Rregullorja (EU) Nr 543/2013) ose aktet ligjore në fuqi të Energjisë Komuniteti dhe / ose legjislacioni kombëtar i zbatueshëm ose çdo vend tjetër përkatës, Aktet administrative si kodet e rrjetit;
 - (d) Aq sa kërkohet nga një gjykatë, arbiter, tribunal administrativ ose një ekspert në rrjedhën e procedurave para së cilës marrësi është palë;
 - (e) Siç mund të kërkohet nga Operatorët përkatës të Sistemit të Transmisionit për përmbushjen e misionit të tyre dhe detyrimet e tyre në përputhje me ligjet në fuqi dhe këto Rregulla Alokimi nga vetë agjentët ose këshilltarët; ose
 - (f) Aq sa kërkohet për të marrë leje ose pëlqime nga një autoritet kompetent
5. Për më tepër, detyrimet që rrjedhin nga ky nen nuk zbatohen:
- (a) Nëse Pala që merr informacionin mund të provojë që në kohën e deklarimit, një informacion i tillë tashmë ishte në dispozicion të publikut;
 - (b) Nëse Pala pritëse jep dëshmi se, që nga koha e deklarimit, informacioni është marrë ligjërisht nga një palë e tretë ose është bërë publike
 - (c) Për informatat konfidenciale të komunikuar, në përputhje me ligjin dhe dispozitat rregullatore, në një formë të inkorporuar nga e cila nuk ka informacion Specifik për një pjesëmarrës në treg;
 - (d) Në informacione, publikimi i të cilave është parashikuar në mënyrë eksplicite nga Rregullat aktuale të Alokimit.
6. Detyrimet e konfidencialitetit në këtë nen mbeten të vlefshme për një periudhë prej pesë (5) vitesh pas përfundimit të Marrëveshjes së Pjesëmarrjes së Pjesëmarrësit të Regjistruar.
7. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Pjesëmarrjes dhe shkëmbimi i informacionit konfidencial nuk u jep asnjë të drejtë patentave, njohurive ose ndonjë forme tjetër të pronësisë intelektuale në lidhje me informacionet ose mjetet e vëna në dispozicion ose të dërguara nga njëra Palë në tjetrën sipas kushteve të këtyre Rregullave Alokimi.

Neni 60

Detyrim dhe nenkontraktim

1. Platforma e alokimit mund të caktojë, novacionojë ose ndryshe të transferojë ndonjë nga të drejtat e saj ose detyrimet sipas një Marrëveshjeje Pjesëmarrëse ose këto

Rregullave të Alokimit një Platforme tjetër Alokimi. Platforma e Alokimit do të njoftojë Pjesëmarrësit e Regjistruar për ndryshim duke komunikuar me një mjet elektronik siç specifikohet nga Platforma e Alokimit në faqen e saj të internetit kundrejt një konfirmimi marrjeje sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast së paku dhjetë (10) Ditë Pune para datës në të cilën ndryshimi hyn në fuqi.

2. Një Pjesëmarrës i Regjistruar nuk mund të caktojë, rinovojë ose ndryshe të transferojë ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Pjesëmarrjes ose Rregullores të Alokimit pa pëlqimin paraprak me shkrim të Platformës së Alokimit.
3. Asgjë në këtë nen nuk do të parandalojë një Platformë Alokimi apo Pjesëmarrës të Regjistruar që të hyjë në një kontratë nënkontraktimi në lidhje me këtë Rregullore të Alokimit. Hyrja në një kontratë nënkontraktimi nga një Pjesëmarrës i Regjistruar nuk e liron Pjesëmarrësin e Regjistruar për asnjë detyrim sipas Marrëveshjes së Pjesëmarrjes ose këtyre Rregullave të Alokimit.

Neni 61

Ligji Qeverisës

Këto Rregulla të Alokimit do të qeverisen dhe interpretohen në të gjitha aspektet në përputhje me Ligjin Belg.

Neni 62

Gjuha

Gjuha e aplikueshme për këto Rregulla të Alokimit duhet të jetë Anglisht. Për shmangien e dyshimeve, në rastet kur Operatorët e Sistemit të Transmetimit duhet të përkthejnë këto Rregulla për Alokimin në gjuhën e tyre kombëtare, në rast të mospërputhjeve midis versionit në gjuhën angleze të publikuar nga Platforma e Alokimit dhe çdo versioni në një gjuhë tjetër, versioni në anglisht i botuar nga Platforma e Alokimit do të ketë prioritet.

Neni 63

Asete Intelektuale

Asnjë Palë nuk do të fitojë asnjë të drejtë, titull, licencë ose interes në ose për të drejtat e aseteve intelektuale të Palës tjetër në lidhje me këto Rregulla të Alokimit.

Neni 64

Marrëdhënia e Palëve

1. Marrëdhënia e Platformës së Alokimit dhe Pjesëmarrësit të Regjistruar është ai i ofruesit të shërbimit dhe shfrytëzuesi i shërbimit. Përveç siç parashikohet shprehimisht në këto Rregulla të Alokimit, askush nuk ka të drejtën të zëvendësojë Platformën e Alokimit ose Pjesëmarrësin e Regjistruar, partnerin, agentin ose përfaqësuesin ligjor

të palës tjetër për çfarëdo qëllimi, duke krijuar ndonjë partneritet, agjensi apo besim ndërmjet Palëve.

2. Pjesëmarrësi i regjistruar pranon që as Platforma e Alokimit, as cilindo person që vepron në emër të tij, të bëjë ndonjë përfaqësim, të japë këshilla ose ndonjë garanci, në lidhje me këto Rregulla të Alokimit, Marrëveshjet e Pjesëmarrjes ose Informacione të publikuara.

Neni 65

Asnjë e drejtë e palës së tretë

1. Platforma e Alokimit dhe çdo Pjesëmarrës i Regjistruar pranojnë që asnjë person i cili nuk është palë në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes midis tyre, përfshirë çdo pjesëmarrës tjetër tregu, nuk ka të drejta për të zbatuar këto Rregulla të Alokimit ose Marrëveshjen e Pjesëmarrjes ndërmjet Platformës së Alokimit dhe Pjesëmarrësit të regjistruar.

Neni 66

Dokumet i Doreheqjes

Asnjë mosveprim për të ushtruar ose vonuar në ushtrimin e ndonjë të drejte, fuqie ose mjete juridik të parashikuar nga ligji ose sipas këtyre Rregullave të Alokimit do të dëmtojë ose përbëjë një heqje dorë nga një e drejtë, fuqi apo mjet tjetër juridik. Asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte, fuqie ose mjete të tillë nuk e përjashton ose pengon ndonjë ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tij ose ushtrimin e çfarëdo të drejte, fuqie ose mjete tjetër të parashikuar nga ligji ose sipas këtyre Rregullave të Alokimit. Asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte, fuqie ose mjete juridik nuk e pengon ushtrimin e ndonjë të drejte, fuqie ose mjete tjetër juridik të parashikuar nga ligji ose sipas këtyre Rregullave të Alokimit.

2. Çdo heqje dorë nga çdo e drejtë, fuqi ose mjet juridik sipas këtyre Rregullave të Alokimit duhet të jetë me shkrim dhe mund t'u jepet subjekteve sipas kushteve të menduara nga koncensiondhënësi. Përveç nëse thuhet shprehimisht ndryshe, çdo heqje dorë është efektive vetëm në rast dhe vetëm për qëllimin për të cilin është dhënë.

Neni 67

Marrëveshja

E gjithë Marrëveshja që këto Rregulla për Alokim dhe Marrëveshja e Pjesëmarrjes përmbajnë, i referohen shprehimisht të gjithë marrëveshjes ndërmjet Platformës së Alokimit dhe secilit Pjesëmarrës të Regjistruar në lidhje me këtë çështje dhe shprehimisht përjashtojnë çdo garanci, kusht ose ndërmarrje tjetër që implikohet me ligj ose me porosi, dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe bashkepunimet e mëparshme ndërmjet Platformës së Alokimit dhe çdo Pjesëmarrësi të Regjistruar në lidhje me to. Platforma e Alokimit dhe secili Pjesëmarrës i Regjistruar pranojnë dhe konfirmojnë që asnjëri prej tyre nuk i bashkohet këtyre Rregullave të Alokimit ose Marrëveshjes së Pjesëmarrjes duke u mbështetur në ndonjë përfaqësim, garanci apo ndërmarrje tjetër (përveçse kur është bere me mashtrim) nuk pasqyrohet plotësisht në kushtet e këtyre Rregullave të Alokimit Ose Marrëveshjen e Pjesëmarrjes.

Neni 68

Procedurat Ligjore

Të drejtat dhe procedurat ligjore të ofruara nga Rregullat për Alokim dhe Marrëveshja e Pjesëmarrjes në Platformën e Alokimit dhe drejt secilit Pjesëmarrës të Regjistruar janë ekskluzive dhe jo kumulativ, deri në masën e lejuar me ligj, do të përjashtohen dhe do zëvendësohen të gjitha procedurat ligjore të pavarura ose të nënkuptuara dhe të parashikuara me ligj ose statute në lidhje me subjektin e këtyre Rregullave të Alokimit dhe Marrëveshjes për Pjesëmarrje. Rrjedhimisht, Platforma e Alokimit dhe secili Pjesëmarrës i Regjistruar, nëpërmjet kësaj heq dorë aq sa të jetë e mundur nga të gjitha të drejtat dhe procedurat të parashikuara me ligj ose me status, dhe lirojnë njëri tjetrin nëse ajo është përgjegjës për ndonjë prej tyre, zyrtarëve, punonjësve dhe agjentëve të saj në të njëjtën masë nga të gjitha detyrimet, përgjegjësitë ose detyrimet e parashikuara nga ligji ose statuti në lidhje me çështjet që trajtohen në këto Rregulla për Alokim dhe Marrëveshjen e Pjesëmarrjes dhe merr përsipër të mos zbatojë asnjë nga të njëjtat, përveç siç parashikohet shprehimisht këtu.

Neni 69

Dispozita në kontratë

Nëse ndonjë dispozitë e këtyre Rregullave të Alokimit ose Marrëveshjes së Pjesëmarrjes shpallet e pavlefshme, e pazbatueshme ose e paligjshme nga gjykatat e juridiksioni të cilës i nënshtrohet ose me urdhër të ndonjë autoriteti kompetent, kjo pavlefshmëri, pazbatueshmëria ose paligjshmëria nuk duhet të ndikojë në dispozitat e mbetura të këtyre Rregullave të Alokimit dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes e cila do të vazhdojë në fuqi dhe efekt të plotë pavarësisht kësaj pavlefshmërie, pazbatueshmëri ose paligjshmëri. Çdo pjesë ose dispozitë e pavlefshme, e paligjshme, e pazbatueshme duhet të zëvendësohet me pjesë ose dispozita të vlefshme ligjore dhe / ose të zbatueshme për të arritur efektin e synuar ekonomik dhe ligjor.

Shtojca 1

Lista e Zonave Ofertuese ku aplikohen Rregullat e Ankandit

<p>Lista e kufijve te Zones se Ofertimit dhe / ose nengrupet e tyre te interkonektoreve</p> <p>Lista e OST-ve pergjegjese</p>	<p>Tipi i te Drejtave Afatgjata te Transmetimit</p>
<p>Kroaci (HR) Bosnje dhe Herzegovina (BiH)</p> <p style="text-align: center;">◇</p> <p>HOPS NOS BiH</p>	<p>PTRs</p>
<p>Bosnje dhe Herzegovina (BiH) Mal i Zi (ME)</p> <p style="text-align: center;">◇</p> <p>NOS BiH CGES</p>	<p>PTRs</p>
<p>Mal i Zi (ME) Shqipëri (AL)</p> <p style="text-align: center;">◇</p> <p>CGES OST</p>	<p>PTRs</p>
<p>Shqipëri (AL) Greqi (GR)</p> <p style="text-align: center;">◇</p> <p>OST IPTO</p>	<p>PTRs</p>
<p>Greqi (GR) Maqedonia e veriut (MK)</p> <p style="text-align: center;">◇</p> <p>IPTO MEPSO</p>	<p>PTRs</p>
<p>Greqi (GR) Turqi (TR)</p> <p style="text-align: center;">◇</p> <p>IPTO TEIAS</p>	<p>PTRs</p>
<p>Kosovë (XK) Shqipëri (AL)</p> <p style="text-align: center;">◇</p> <p>KOSTT OST</p>	<p>PTRs</p>

Kosovë (XK)		Mai i Zi (ME)	PTRs
KOSTT	◊	CGES	
Kosovë (XK)		Maqedoinia e veriut (MK)	PTRs
KOSTT	◊	MEPSO	

Kjo listë e Zonave të Ofertimit në të cilën zbatohen Rregullat e Alokimit mund të ndryshohet ose të plotësohet në përputhje me dispozitat e Nenit 52 (Kohëzgjatja dhe ndryshimi i Rregullave të Alokimit)

SHTOJCA 2

Lista e kufijve të Zonës së Ofertimit ku Kodi i Regjistrimit ACER i caktuar nga Agjencia Evropiane për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) është parakusht për pjesëmarrje në procesin e alokimit.

Lista e Kufijve të Zonës së Ofertimit		
Kroacia (HR) HOPS	◊	Bosnja dhe Hercegovina (BiH) NOS BiH